




Funded by  
the European Union

# ZBATIMI NË INTERNET I TË DREJTAVE TË PRONËS INTELEKTUALE

## UDHËZUES PËR ZYRTARËT E ZBATIMIT TË LIGJIT



## SHKURTESAT

<b>ACPO</b>	Shoqata e Zyrtarëve të Lartë Policorë
<b>CDN</b>	Rrjeti i Ofrimit të Përmbajtjeve.
<b>DNS</b>	Sistemi i Emrave të Domeneve
<b>EUIPO</b>	Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësi Intelektuale.
<b>BPV</b>	Bruto-Produkti Vendor.
<b>IEC</b>	Komisioni Elektro-Teknik Ndërkombëtar.
<b>IIPCIC</b>	Kolegji Ndërkombëtar i Hetuesve të Krimin në PI.
<b>IP</b>	Protokolli i Internetit.
<b>API</b>	Agjencia e Pronësisë Industriale.
<b>DPI</b>	Të drejtat e pronësisë intelektuale.
<b>IPTV</b>	Televizion në Protokoll Interneti.
<b>ISO</b>	Organizata Ndërkombëtare e Standardeve
<b>ZDA</b>	Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përafërta
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.
<b>OSINT</b>	Inteligjenca në burime të hapura.
<b>SEO</b>	Optimizimi i motorëve të kërkimit.
<b>TCP</b>	Protokolli i Kontrollit të Transmisionit.
<b>TOR</b>	Projekti Router Onion.
<b>TRIPS</b>	Marrëveshja për Aspektet që ndërlidhen me tregtinë e të Drejtave të pronësisë intelektuale.
<b>UNODC</b>	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin.
<b>VCP</b>	Praktikat e bashkëpunimit vullnetar.
<b>VM</b>	Makinë Virtuale.
<b>VPN</b>	Rrjet Virtual Privat.
<b>WCO</b>	Organizata Botërore e Doganave.
<b>WIPO</b>	Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale.
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetit.

# **PËRMBAJTJA**

## **1. Hyrje**

- 1.1 Qëllimi i Udhëzuesit
- 1.2 Pronësia intelektuale
- 1.3 Krimi ndaj DPI-ve - Falsifikimi dhe Pirateria
- 1.4 Ndikimi në Shoqëri i Shkeljeve të DPI-ve
- 1.5 Mohimi i Përgjegjësisë.

## **2. Sistemi i Pronësisë Intelektuale**

- 2.1 Institucionet qeveritare
- 2.2 Bashkëpunimi

## **3. Shkeljet e DPI-ve në internet**

- 3.1 Hyrje
- 3.2 Llojet e shkeljeve të DPI-ve në internet

## **4. Legjislacioni**

- 4.1 Hyrje
- 4.2 Marrëveshja TRIPS
- 4.3 Konventa e Krimin Kibernetik
- 4.4 Legjislacioni vendor

## **5. Masat për Zbatimin e DPI-ve në internet**

5.1 Hyrje

5.2 Marrja e informatave të llogarisë

5.3 Bllokimi i qasjes në faqet e internetit

5.4 Veprimet me emër domeni

5.5 Veprimet që shënjestrojnë mbajtësit e domeneve (host)

5.6 Pastrimi i parave

## **6. Masat e zbatimit vullnetar**

6.1 Hyrje

6.2 Shembull i masës së zbatimit vullnetar

## **7. Hetimet virtuale**

7.1 Hyrje

7.2 Hetimi “Përcille Transmetimin”

7.3 Hetimi “Përcille Paranë”

7.4 Hetimi “Përcille Paranë”

7.5 Praktikat më të mira

## **8. Inteligjenca nga burime të hapura**

8.1 Hyrje

## **9. Provat digjitale**

9.1 Hyrje

9.2 Vendi i ngjarjes - skena e krimit

9.3 Çështje Pajisjesh dhe Pakoja e veglave të hetimit

9.4 Llojet e të dhënave

9.5 Grackat e bombat

9.6 Depozitimi dhe Ruajtja e Provave digjitale

## **10. Mësime të tjera**

10.1 Kolegji i Hetuesve të Krimit ndaj PI-së

Shtojca I - Objektet e PI-së

Shtojca II - Informatat e Kontaktit

Shtojca III - Legjislacioni

Shtojca IV - Përkufizimet

# 1. HYRJJE

## 1.1 Qëllimi i Udhëzuesit

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të rrisë vetëdijen e Policisë së Kosovës në raport me rëndësinë e pronës intelektuale dhe kërcënimin tejet real ndaj shoqërisë nga shkelja e të drejtave të pronës intelektuale (DPI). Udhëzuesi gjithashtu do të nxjerrë në pah sistemin kombëtar të PI-së dhe legjislacionin vendor që zbatohet për mbrojtjen dhe përmbarimin e DPI-ve në internet. Përveç kësaj, Udhëzuesi do të përshkruajë se si Policia e Kosovës mund të zbatojë DPI-të praktikisht në internet.

Udhëzuesi i dytë me titull “*Zbatimi në fushën penale i të drejtave të pronësisë intelektuale - Udhëzues për Zyrtarët e Zbatimit të ligjit*” është hartuar për të ndihmuar Policinë e Kosovës të hetojë shkeljet e DPI-ve që **nuk** janë kryer në mjedise virtuale. Të dy udhëzuesit plotësojnë njëri-tjetrin dhe të dy duhet të lexohen bashkërisht për të fituar një pasqyrë të qartë të sfidave të zbatimit të DPI-ve në Kosovë.

## 1.2 Pronësia intelektuale

Sipas Kombeve të Bashkuara, krimet ndaj DPI-ve janë aktivitete kriminale ndërkombëtar i menaxhuar nga të njëjtat organizata kriminale që përfshihen në krime të tjera të rënda, përfshirë trafikimin e narkotikëve, kontrabandimin e armëve, trafikimin me njerëz, korrupsionin dhe pastrimin e parave<sup>1</sup> - por çfarë është pronësia intelektuale?

Prona intelektuale i referohet krijimeve mendore, si shpikjet, veprat letrare, veprat artistike, simbolet, emrat, imazhet dhe dizajnet që përdoren në tregti.<sup>2</sup> Për më tepër, prona intelektuale tradicionalisht ndahet në dy kategori:

- **Prona Industriale** që përfshin markat tregtare, dizajnet industriale, patentat dhe indikacionet (treguesit) gjeografikë; dhe
- **E drejta e autorit** që përfshin veprat letrare (të tilla si romane, poezi dhe drama), filmat, muzikën, veprat artistike (p.sh., vizatime, piktura, fotografi dhe skulptura), softuere dhe dizajn arkitektonik. Të drejtat e përfaqësuara me të drejtat e autorit janë

<sup>1</sup>Falsifikimi. Përhapje globale. Kërcënim global. UNICRI.

<sup>2</sup>Organizata Botërore të Pronësisë Intelektuale - Çfarë është Prona Intelektuale? [www.wipo.int](http://www.wipo.int)

ato të artistëve interpretues në interpretimet e tyre, prodhuesit e fonogrameve në regjistrimet e tyre dhe transmetuesve në programet e tyre në radio dhe televizion.<sup>3</sup>

Për të siguruar mbrojtje të **pronës industriale** në Kosovë, me disa përjashtime<sup>4</sup>, krijuesi, ose pronari, duhet të regjistrohet për mbrojtje në një agjenci qeveritare të quajtur Agjencia e Pronësisë Industriale (API). Sidoqoftë, **mbrojtja e të drejtës së autorit** sigurohet automatikisht me vënien e shenjës në vepër, pa pasur nevojë për regjistrim apo formalitete të tjera.

Pronarët e pronës intelektuale kanë të drejta të caktuara, përfshirë aftësinë për të autorizuar dhe ndaluar të tjerët të përdorin pronën e tyre intelektuale. Në fakt, të drejtat e pronësisë intelektuale janë si çdo e drejtë tjetër pronësore. Ato i mundësojnë krijuesve, ose pronarëve, të përfitojnë nga puna ose investimi i tyre në një krijim. Këto të drejta përshkruhen në nenin 27 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila parasheh të drejtën për të përfituar nga mbrojtja e interesave morale dhe materiale që rezultojnë nga autorësia e prodhimeve shkencore, letrare ose artistike. Përveç kësaj, në nenin 46 (5) të Kushtetutës së Kosovës thuhet “Prona intelektuale mbrohet me ligj”.

Pa DPI për të shpërblyer kreativitetin dhe për të inkurajuar inovacionin nuk është fort e sigurt që shpikësit ose krijuesit do të kishin mjete financiare apo motivim për të zbuluar ilaçe të reja, si ilaçet e kancerit që shpëtojnë jetë, ose të zhvillojnë teknologji që përmirësojnë cilësinë e jetës sonë. Rrjedhimisht, është qenësore që qeveritë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit të zbatojnë DPI-të jo vetëm për të mbrojtur të drejtat e pronarëve, por për të lehtësuar përparimin e shoqërisë.

Ekzistojnë shumë lloje të objekteve të pronës intelektuale që mbrohen në Kosovë, të gjitha janë të renditura në Shtojcën I, por Policia e Kosovës më së shpeshti merret me markat tregtare dhe të drejtat e autorit:

- Markat tregtare janë shenja, që përfshijnë fjalët dhe logot, të cilat identifikojnë brendet (emrat) dhe u mundësojnë konsumatorëve të

<sup>3</sup>Organizatata Botërore të Pronësisë Intelektuale - Cfarë është Prona Intelektuale? [www.wipo.int/about-ip/en/](http://www.wipo.int/about-ip/en/)

<sup>4</sup> Markat e njohura tregtare mbrohen pa regjistrim, në pajtim me nenin 6bis të Konventës së Parisit.



torëve të dallojnë mallrat dhe shërbimet në treg. Shembuj të markave tregtare janë fjalët “Coca Cola” dhe “Nike”; ndërsa

- E drejta e autorit mbron veprat krijuese si veprat letrare, filmat, muzika, veprat artistike, softuerët dhe projektimet arkitektonike.

Markat tregtare dhe e drejta e autorit mund të kombinohen për të ofruar mbrojtje, për shembull:

- Marka e regjistruar tregtare mbron emrin dhe simbolin e një makine; dhe
- E drejta e autorit mbron softuerin e makinës, manualin e pronarit dhe imazhet.

Mbrojtja e pronës intelektuale është e kufizuar në kohë. Sidoqoftë, kohëzgjatja e mbrojtjes ndryshon për secilin objekt të pronësisë intelektuale. Për shembull, e drejta e autorit për veprat individuale mbrohet për gjithë jetën e autorit, plus 70 vjet. Në të kundërtën, markat tregtare, të cilat fillimisht mbrohen për 10 vjet nga koha kur dorëzohet aplikacioni në API, mund të mbrohen pa afat nëse pronari vazhdon të dorëzojë kërkesa për zgjatje të mbrojtjes në API çdo 10 vjet.

### 1.3 Krimi ndaj DPI-ve - Falsifikimi dhe Pirateria

Subjekti shkel DPI-të kur përdor pronën intelektuale pa lejen e pronarit. Përdorimi i paautorizuar i pronës intelektuale është potencialisht vepër e rëndë.

**Falsifikimi dhe pirateria** janë shkelje të DPI-ve që i referohen përdorimit të paautorizuar të **markave tregtare**, respektivisht të të **drejtës së autorit**.

Kriminelët e organizuar shpesh kontrabandojnë mallra të falsifikuara dhe pirate duke përdorur të njëjtat rrugë që përdoren për kontrabandën e narkotikëve dhe armëve. Në fakt, fitimprurja nga mallrat e falsifikuara dhe pirate shpesh tejkalon atë të krimeve tjera, edhe të narkotikëve.

## 1.4 Ndikimi në Shoqëri i Shkeljeve të DPI-ve

### Ekonomia

Një studim i vitit 2019 nga Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësi Intelektuale (EUIPO) dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) vlerësoi se tregtia ndërkombëtare e falsifikimit dhe piraterisë kishte vlerë deri në 509 miliardë dollarë në vit. Sidoqoftë, ky vlerësim nuk përfshinte produktet e paligjshme të prodhuara dhe konsumuara brenda vendit e as produktet digjitale jomateriale. Po të përfshiheshin këto produkte, studimi i EUIPO-së dhe OECD-së vlerëonte se vlera e tregtisë ndërkombëtare me mallra të falsifikuar dhe pirate do të ishte disa qindra miliardë dollarë më shumë se vlera prej 509 miliardë dollarë.<sup>5</sup>

Studimi i EUIPO-së dhe OECD-së nënvizon shkallën e fondeve që Qeveritë dhe bizneset legjitime humbin nga tregtia me mallra të falsifikuar dhe pirate. Fonde këto që do të mund të përdreshin për të avancuar shoqërinë (p.sh. ndërtimi i shkollave, ndërtimi i spitaleve etj.) dhe për të krijuar vende të punës.

### Shëndeti e siguria

Studimi i EUIPO-së dhe OECD-së po ashtu zbuloi se falsifikimi nuk kufizohet në sende luksoze, siç janë orët dhe veshjet e stilistëve, por është zgjeruar për të përfshirë barnat, ushqimet, pijet, pajisjet mjekësore, artikuj të kujdesit personal, lodra, duhan dhe pjesë automobilash, duke kërcënuar kështu shëndetin dhe sigurinë e konsumatorit.

Interpol-i thotë që “falsifikimi i markave tregtare dhe piratimi i të drejtës së autorit janë vepra të rënda ndaj pronës intelektuale, që mashtrjnë konsumatorët, kërcënojnë shëndetin dhe sigurinë, i kushtojnë shoqërisë miliarda dollarë në kuptimin e humbjes së të ardhurave të qeverisë, investimeve të huaja ose fitimeve të biznesit, si dhe shkelin të drejtat e pronarëve të markave tregtare dhe të të drejtave të autorit. Produktet e imituara përbëjnë kërcënim të konsiderueshëm

<sup>5</sup>Trendet e tregtisë me mallra të falsifikuar dhe Piratë, EUIPO dhe OECD, 2019.

ndaj sigurisë së konsumatorëve në të gjithë botën. Konsumatorët që nuk dyshojnë e vënë në rrezik shëndetin e tyre dhe madje edhe jetën, sa herë që përdorin produkte, pije alkoolike dhe produkte ushqimore të falsifikuara, apo udhëtojnë me automobila dhe aeroplanë të mirëmbajtur me pjesë të falsifikuara dhe nën standarde”.<sup>6</sup>

Ndërsa Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) deklaroi që ilaçet “e falsifikuara” dhe produktet tjera të tilla shëndetësorë mund të kenë efekte të dëmshme në shëndetin e pacientëve, përfshirë vdekjen”.<sup>7</sup>

## Krimi i organizuar

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) ka vlerësuar që tregu global i barnave të paligjshme të jetë mbi 320 miliardë dollarë.<sup>8</sup> Kjo shifër është më e vogël sesa vlerësimi i EUIPO-së dhe OECD-së për vlerën e tregtisë ndërkombëtare me mallra të falsifikuar dhe pirate, që është deri në 509 miliardë dollarë, duke theksuar këtu atraktivitetin e falsifikimit dhe piraterisë për krimin e organizuar, veçanërisht kur krahasohen mjetet që qeveritë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit ndajnë për të luftuar tregtinë e paligjshme të drogës me ato të ndara për luftimin e tregtisë me mallra të falsifikuar dhe pirate.

Sipas Interpol-it, “Kriminalët e organizuar tejkuftarë sigurojnë qindra miliarda dollarë në vit nga prodhimi dhe shpërndarja e produkteve false (falsifikim dhe pirateri), pjesërisht për shkak të nivelit relativisht të ulët të rrezikut, si dhe nivelit relativisht të lartë të fitimit. Ekziston nevoja gjithnjë e më e madhe për mundësimin dhe koordinimin e përpjekjeve ndërkombëtare në luftimin e këtij kriminaliteti, i cili vepron përtej kufijve ndërkombëtarë dhe ka pasoja shumë të rënda për publikun”.<sup>9</sup>

## 1.5 Mohimi i Përgjegjësisë

Ky dokument nuk shfuqizon, e as nuk ka për qëllim të zëvendësojë kërkesat e të drejtës ndërkombëtare, ligjeve vendore, apo të ndonjë rregulloreje apo politike qeveritare.

<sup>6</sup>Kolegji Ndërkombëtar i Hetuesve të Krimin të Pronës Intelektuale, Interpol, 2016.

<sup>7</sup>Task-Forca Ndërkombëtare Kundër Produkteve Medicinale të Falsifikuara, 2015

<sup>8</sup>Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat, Raporti Vjetor, 2014.

<sup>9</sup>Kolegji Ndërkombëtar i Hetuesve të Krimin të Pronës Intelektuale, Interpol, 2016.

## 2. SISTEMI I PRONËSISË INTELEKTUALE

### 2.1 Institucionet qeveritare

#### Hyrje

Në Kosovë, luftimi i shkeljeve të DPI-ve, duke përfshirë falsifikimin dhe piraterinë, kërkon efektivisht përpjekje të koordinuara nga institucione të shumta, duke përfshirë:

- Agjencia e Pronësisë Industriale (API);
- Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përafërta (ZDA);
- Doganat e Kosovës;
- Inspektorati i Tregut;
- Policia e Kosovës;
- Këshilli Prokurorial; dhe
- Këshilli Gjyqësor.

#### Agjencia për Pronësi Industriale

Agjencia për Pronësi Industriale (API) është organ administrativ brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ka selinë në Prishtinë dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- Zhvillimin e procedurave për lëshimin e patentave, çertifikatave suplementare të mbrojtjes;
- Zhvillimin e procedurave për regjistrimin e markave tregtare, dizajneve industriale, topografive të qarqeve të integruara, emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë;
- Përpilimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të përcaktuar me Ligjin bazë;
- Propozon, harton dhe publikon Buletinin Zyrtar të API-së, që përmban të dhëna për aplikimin dhe të drejtat e dhëna për pronësinë industriale;

- Kontribuon, zhvillon dhe promovon mbrojtjen e pronësisë industriale;
- Inicion dhe propozon ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale;
- Ofron shërbime informuese lidhur me objektet e pronësisë industriale;
- Organizon testimin për përfaqësues të autorizuar në fushën e të drejtave të pronësisë industriale;
- Përgatit propozime për miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e pronësisë industriale;
- Bashkëpunon me organet tjera në funksion të zbatimit të dispozitave ligjore që rregullojnë pronësinë industriale; si dhe
- Përfaqëson Kosovën në organizatat ndërkombëtare për pronësinë industriale.<sup>10</sup>

IPA mund të ndihmojë policinë dhe prokurorët:

- Të konfirmojnë nëse një pronë industriale (p.sh. markë tregtare, dizajn industrial etj.) është e mbrojtur në Kosovë; dhe
- Të identifikojnë pronarin e një të drejte të pronësisë industriale.

## **Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përfaqësuara**

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura (ZDA) është njësi brenda Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ka selinë në Prishtinë dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- Dhënien e lejes shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave;
- Mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve të shoqatave për administrim kolektiv;
- Revokimin e lejeve të dhëna Shoqatave për administrim kolektiv;
- Dhënien e informatave autorëve, bartësve të të drejtave dhe opinionit të gjerë lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuara;

<sup>10</sup>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=2,17>

- Përcjelljen e legjislacionit ndërkombëtar dhe dhënien e rekomandimeve për Qeverinë.<sup>11</sup>

ZDA mund të ndihmojë policinë dhe prokurorët të kontaktojnë shoqatat e administrimit kolektiv, të cilat mund të:

- Konfirmojnë nëse e drejta e autorit apo ndonjë e drejtë e përafërt mbrohet në Kosovë; dhe
- Identifikojnë pronarin e të drejtës së autorit apo të drejtës së përafërt.

## Dogana e Kosovës

Dogana e Kosovës është pjesë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Selia e saj është e vendosur në Prishtinë, por kanë edhe pika kontrolli në:

Aeroport.	Merdarë.	Qafë Morinë.	Zubin Potok.
Dheu i Bardhë.	Muçibabë.	Qafa e Prushit.	Mitrovica.
Hani i Elezit.	Mutivodë.	Vërmicë.	Podujevë.
Interevropa.	Pejë.	Leposaviq.	Kulla. <sup>12</sup>
Selia Prishtinë	Gllboçicë		

Përgjegjësi e Doganave të Kosovës janë edhe parandalimi i importit dhe eksportit të mallrave të cilat shkelin DPI-të.

Të gjithë zyrtarët doganorë janë të autorizuar të veprojnë sipas detyrës zyrtare për të penguar mallrat për të cilët dyshojnë se shkelin DPI-të, e përveç kësaj, ekziston një njësi e veçantë e DPI-ve brenda Departamentit të Hetimeve Operative të Drejtorisë së Zbatimit të Ligjit. Njësia e DPI-ve është e vendosur në Zyrën Qendrore dhe përgjegjësitë e saj janë:

- Pranimi i kërkesave për veprim nga bartësit e DPI-ve;
- Shpërndarja e kërkesave të pranuar për DPI për veprim tek pikat e kontrollit;

<sup>11</sup>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit <https://www.mkrs-ks.org/?page=2,102>

<sup>12</sup>[Dogana e Kosovës](http://www.dogana-ks.org) www.dogana-ks.org

- Trajnim për DPI-të për zyrtarët doganorë dhe
- Komunikimet me bartësit e të drejtave PI.

Dogana e Kosovës mund t'i ofrojë policisë dhe prokurorëve detajet e dërgesave që ata kanë kapur me mallra që shkelin DPI-të, përfshirë emrin e importuesit dhe/ose eksportuesit. Dogana e Kosovës mund të kontrollojë edhe historinë e dërgesave në adresa ose subjekte, të cilat shënjestrohen nga policia dhe prokurorët.

## **Inspektorati i Tregut**

Inspektorati i Tregut është organ ekzekutiv brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që bën mbikëqyrjen e tregut në territorin e Kosovës. Selia e tij është e vendosur në Prishtinë, por ka edhe zyra të tjera në Kosovë.

Autoritetet inspektuese të tregut kanë kompetencat dhe resurset për të:

- Inspektuar lokacionet që ndërlidhen me tregtinë;
- Kontrolluar dokumentacionin e biznesit;
- Inspektuar mallrat dhe shërbimet;
- Kërkuar informata lidhur me biznesin;
- Sekuestruar provat e veprave penale të lidhur me tregtinë;
- Penguar lëshimin e mallrave dhe shërbimeve në treg; dhe
- Pezulluar biznesin nga veprimi.

Përgjegjësi e Inspektoratit të Tregut është edhe të siguroarit që mallrat dhe shërbimet që prodhohen ose përdoren në tregti, në Kosovë, të mos shkelin DPI-të.

Inspektorati i Tregut mund të ndihmojë policinë dhe prokurorët të hetojnë bizneset për të cilët dyshojnë se prodhojnë, importojnë, eksportojnë ose shesin mallra ose shërbime që shkelin DPI-të.

## **Policia e Kosovës**

Policia e Kosovës është pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Selia e saj gjendet në Prishtinë, por Policia ka prani në secilën komunë.

Të gjithë zyrtarët policorë mund të veprojnë sipas detyrës zyrtare për të parandaluar shkeljet e DPI-ve. Sidoqoftë, ankesat në lidhje me shkeljet e DPI-ve, të cilat nuk përfshijnë protokollet për internetin, e që kërkojnë hetim, duhet të referohen tek Njësia për Krimet Ekonomike, në Drejtorinë e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit. Në të kundërt, ankesat në lidhje me shkeljet e DPI-ve e që përfshijnë protokollet për internet duhet të referohen tek “Njësia e Krimit Kibernetik”.

## **Prokuroria e Shtetit**

Prokuroria e Shtetit është institucion i pavarur, me autorizime e përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar, për kryerjen e veprave penale ose akte të tjera të parapara me ligj. Ajo përfshin:

- Prokurorinë Themelore;
- Prokurorinë e Apelit;
- Prokurorinë Speciale; dhe
- Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.<sup>13</sup>

Prokurori i Shtetit nuk ka njësi specifike për DPI, por, të gjithë prokurorët janë kompetentë për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e DPI-ve, qoftë sipas detyrës zyrtare ose në bazë të kallëzimit penal.

Detajet e kontaktit për secilin prej institucioneve mund të gjenden në Shtojcën II.

---

<sup>13</sup>Prokuroria e Shtetit <https://www.rks-gov.net/EN/f46/judiciary/state-prosecutor/>



## 2.2 Bashkëpunimi

### Këshilli Shtetëror i Pronësisë Intelektuale

Në shumicën e vendeve, ka disa institucione të ngarkuara me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë. Shpesh, këto institucione kanë përgjegjësi të ndërthurura. Rrjedhimisht, i takon qeverisë dhe institucioneve të zhvillojnë një model bashkëpunimi që do të sigurojë mbrojtjen efikase dhe efektive të DPI-ve.

Në Kosovë, qeveria ka themeluar Këshillin Shtetëror të Pronës Intelektuale për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të përfshira në mbrojtjen dhe zbatimin e DPI-ve.

Këshilli ofron këshilla dhe ndihmë për Qeverinë dhe palët e tjera të interesit të përfshira në mbrojtjen dhe zbatimin e DPI-ve.

Këshilli përfshin përfaqësues nga institucionet e diskutuara nën titullin **2.1 Institucionet Qeveritare**, posaçërisht:

- Agjencia e Pronësisë Industriale (API);
- Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përfaqësuara (ZDA);
- Doganat e Kosovës;
- Inspektorati i Tregut;
- Policia e Kosovës;
- Këshilli Prokurorial; dhe
- Këshilli Gjyqësor.

Për më tepër, përfaqësues nga institucionet e mëposhtme janë gjithashtu anëtarë vëzhgues të Këshillit:

- Agjencia e Barnave dhe Produkteve Medicinale, për këshilla mbi ilaçet, si dhe pajisjet mjekësore, të falsifikuara, përfshirë ato të kontrabanduara;
- Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit, për këshilla për ushqime dhe pije të falsifikuara;

- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, për këshilla për çështje mjedisore; dhe
- Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për këshilla për konfiskimin e pasurive nga kriminelët e DPI-ve.

## Task-Forca kundër Piraterisë dhe Falsifikimit

Më 4 tetor 2012, qeveria miratoi **Strategjinë kundër Piraterisë dhe Falsifikimit**, që mbulon periudhën nga viti 2012 deri më 2016. **Strategjia** u hartua nga ZDA-ja, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e DPI-ve. **Strategjia** kishte për qëllim krijimin e mekanizmave për luftimin e falsifikimit dhe piraterisë për të përmirësuar imazhin dhe ekonominë e Kosovës.

Strategjia krijoi një Task-Forcë me misionin e mëposhtëm:

- Promovimi i bashkëpunimit efektiv midis autoriteteve publike dhe organizatave shoqërore dhe ekonomike në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit;
- Sigurimi dhe koordinimi i zbatimit të Strategjisë dhe planit të veprimit kundër piraterisë dhe falsifikimit;
- Zhvillimi dhe zbatimi i programeve dhe fushatave të ndërgjegjësimin publik; dhe
- Përgatitja dhe dorëzimi i propozimeve për hartimin e legjislacionit në lidhje me zbatimin e të drejtës së autorit

Task Forca përfshin anëtarët e mëposhtëm të përhershëm:

- Drejtori i ZDA-së;
- Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut;
- Drejtori i API-së;
- Udhëheqësi i Sektorit të Pronësisë Intelektuale, Dogana;
- Shefi i Sektorit të Hetimit të Krimeve Ekonomike, Policia;
- Shefi i sektorit të hetimit të krimit kibernetik, Policia;

- Përfaqësuesi i Prokurorisë së Shtetit; dhe
- Shefi i Agjencisë për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Ministria e Drejtësisë.

Përveç anëtarëve të përhershëm, organet e mëposhtme mund të ftohen të marrin pjesë në takime:

- Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur të Mediave;
- Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të Autoritetit Rregullator për Komunikimet Postare dhe Elektronike; dhe
- Institucione dhe organizata të tjera të pavarura.

Është gjithashtu me vend të theksohet se organizatat e mëposhtme ndërkombëtare kanë njësi të dedikuara të PI-së që mund të jenë në gjendje të ndihmojnë në ndërtimin e kapaciteteve dhe me hetime ndërkufitare:<sup>14</sup>

- Europol;
- Interpol;
- Komisioni Evropian (Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Bashkimit Doganor);
- Organizata Botërore e Doganave (OBD); dhe
- Observatori EUIPO për shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Detajet e kontaktit për secilin prej institucioneve mund të gjenden në Shtojcën II.

<sup>14</sup>Njësia Ndërkombëtare e Zbatimit të Ligjit (ILECU) e Policisë së Kosovës mund të ndihmojë në koordinimin ndërkombëtar.

## 3. SHKELJET E DPI-VE NË INTERNET

### 3.1 Hyrje

Shkeljet e DPI-ve po ndodhin gjithnjë e më shumë në mjediset virtuale. Ky kërcënim në rritje jo vetëm ndaj ekonomisë, por edhe ndaj shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve ka çuar në disa shpallje së fundi për politika nga qeveritë përkatëse dhe agjencitë e zbatimit të ligjit.<sup>15</sup>

Për më tepër, shkeljet e IPR në mjediset virtuale janë të ndryshme, si në kuptimin e 'përmbajtjes' së shkeljes, ashtu edhe në kuptimin e mjeteve teknologjike të përdorura.<sup>16</sup>

### 3.2 Llojet e shkeljeve të DPI-ve në internet

#### Shpërndarja e paligjshme e veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit.

Shkelja e të drejtës së autorit, ose pirateria, lind sa herë që një vepër e mbrojtur përdoret pa autorizimin e bartësit të së drejtës së autorit dhe kur kjo veprimtari nuk mund të konsiderohet si përdorim i lejuar nën ndonjërin nga përjashtimet ose kufizimet e zbatueshme të së drejtës së kopjimit.<sup>17</sup>

Në epokën e internetit, shkelja e të drejtës së autorit është bërë më e lehtë, edhe kur kryhet në shkallë industriale. Katër metoda popullore të përdorura për të shkelur të drejtat e autorit në internet janë:

- **Striming (Streaming):** kjo kategori përfshin çdo faqe interneti që kryesisht lejon qasjen në përmbajtje të paautorizuar përmes transmetimit në internet direkt nga një shfletues i përdoruesit fundor. Faqet e tilla zakonisht ofrojnë një gamë të gjerë përmbajtjeje, të kërkueshme drejtpërdrejt brenda faqes. Disa faqe

<sup>15</sup>Vlerësimi i Kërcënimit të Krimin të Organizuar dhe të Organizuar të Europolit (2017), Plani i veprimit doganor i BE-së për të luftuar shkeljet e PI-së (2018-2022), Komunikata e Komisionit Evropian për një Plan Veprimi të Pronës Intelektuale (COM 2020 760) dhe Europol dhe EUIPO Vlerësimi i Kërcënimeve nga Krimi me Prona Intelektuale (2019)

<sup>16</sup>'Hulumtim për modelet e biznesit në internet që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale', EUIPO, 2016.

<sup>17</sup>Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përafërta, Kapitulli IV - Kufizimet e të Drejtave të Autorit.

mbajnë vetë përmbajtje të paautorizuar, por shumica ofrojnë vegëza drejt mbajtësve të jashtëm të domeneve (host - duhet të theksohet se Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian<sup>18</sup> ka vendosur që kopjet kalimtare të bëra në kompjuterin e përdoruesit të fundit ndërsa shikojnë transmetimin përbëjnë, si rregull, shkelje të së drejtës së riprodhimit dhe nuk përfiton nga përjashtimi për aktet e përkohshme të riprodhimit).<sup>19</sup>

- **Shkarkimi** (download): përfshin çdo faqe që kryesisht mundëson përdorimin e përmbajtjes së paautorizuar përmes shkarkimit të drejtpërdrejtë në shfletuesin (browser) e përdoruesit. Faqet në këtë kategori zakonisht ofrojnë një gamë të gjerë përmbajtjeje, të kërkueshme drejtpërdrejt brenda faqes, si dhe të shkarkueshme në tërësinë e tyre. Faqet rrallë kanë hosting të vetin për përmbajtje, si dhe ofrojnë vegëza për faqe të tjera që ofrojnë përmbajtjen;
- **Kopjimi në transmetim**: faqet në këtë kategori mundësojnë kopjimin (ripping), kryesisht të audio-dosjeve, në skedarë të shkarkueshëm. Ky proces zhvillohet drejtpërdrejt në shfletuesin e internetit të përdoruesit. Zakonisht, përdoruesi thjesht duhet të shënojë URL-në për të filluar menjëherë shkarkimin e skedarit MP3. Kopjimi i transmetimit përdoret zakonisht për të kopjuar audion nga video-klipet, shpesh nga burime legjitime. Disa faqe i mundësojnë përdoruesve të kopjojnë përmbajtjen e videos dhe ta ruajnë atë si video-xhirim; dhe
- **Torrent**: portali për shkarkimin e torrentëve i mundëson vizitorit të kërkojë çfarëdo përmbajtjeje, e pastaj të shkarkojë një skedar të vogël që fillon procesin e shkarkimit të produktit të plotë. Përdoruesit e faqeve me torrentë duhet të kenë të instaluar në pajisjen e tyre një program të veçantë, të quajtur klient torrenti. Ky është proces shkarkimi peer-to-peer (P2P - nga kompjuteri në kompjuter), kështu që përmbajtja nuk merret drejtpërdrejt nga faqja e internetit, por vjen nga përdorues të tjerë të torrentëve

---

18 Edhe pse nuk është anëtare e BE-së, Kosova është vend kandidat potencial për anëtarësim në BE.

19 Rasti CJEU C-527/15, Filmspeler.

që e ndajnë të njëjtën përmbajtje. Torrentët mund të jetë publikë, ku të gjitha portalet e shkarkimit të torrentëve janë të hapura për këdo, ose privatë, ku vetëm anëtarët e faqes mund të futen dhe të qasin përmbajtjen e faqes. Shumica e faqeve private të torrenteve përdorin politikën “vetëm me ftesë” për anëtarësim.

## Shpërndarja e Mallrave që shkelin DPI-të

Sipas shifrave nga Eurostat, rreth 71% e përdoruesve të internetit në BE kanë blerë në internet në vitin 2019<sup>20</sup>, ndërsa një pjesë e madhe e kësaj tregtie është zhvilluar përmes tregjeve në internet, platformave të mediave sociale dhe dyqaneve virtuale që operojnë me emër në domen të veçantë.

Rritja e tregtisë legjitime në internet megjithatë shkon paralelisht me rritjen e tregtisë së paligjshme. Si pasojë, tregjet në internet, platformat e mediave sociale dhe dyqanet virtuale po përdoren nga shitësit jo vetëm për të shitur mallra të ligjshëm, por edhe për të shitur mallra të paligjshëm, si rrobat e falsifikuara dhe telefona mobilë të falsifikuar (imitime)<sup>21</sup>. Për më tepër, faqet e internetit, të cilat në pamje të parë duket se janë faqe zyrtare të një brendi të caktuar, ndonjëherë rezultojnë të jenë faqe false, e që shesin mallra të imituara. Këto faqe në internet shpesh përdorin emra domeni që përfshijnë markë tregtare të palëve të treta, ndërsa vetë përmbajtja dhe dizajni i faqes së internetit i ngjajnë atyre të pronarit të brendit<sup>22</sup>.

## Mashtrimi, zhvatja dhe vepra të tjera tradicionale të krimin kibernetik

Markat tregtare përdoren për veprime që janë vepra penale që nga fillimi, të tilla si skemat *fishing*. Termi *fishing* përdoret për të përshkruar përpjekjet keqdashëse për të siguruar para, informata të ndjeshme dhe/ose instaluar virusë malware, të cilat fillojnë përmes kontaktit me

<sup>20</sup>Siç përmendet në Tabelën e Agjendës Digjitale, 2019 <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/use-internet> dhe gjendet tek [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/E-commerce\\_statistics\\_for\\_individuals](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/E-commerce_statistics_for_individuals)

<sup>21</sup>Shembuj ilustrues mund të gjenden tek Kapitulli 8 dhe 9 në ‘Hulumtimi për Modelet e Biznesit Virtual që Shkelin të Drejtat e Pronësisë Intelektuale’, EUIPO, 2016.

<sup>22</sup>Shih ‘Hulumtimi për modelet e biznesit virtual që shkelin të drejtat e pronës intelektuale - Faza 2 Dyqanet elektronike të dyshuara për shkeljen e markave tregtare e që përdorin emra domenesh të përdorur më parë’, EUIPO 2017.

viktimat potenciale përmes emailave, postimeve në platformat e mediave sociale, blogjeve ose mesazheve me tekst. Përpjekja për fishing në pamje të parë duket se dërgohet në mirëbesim dhe për qëllime legjitime. Për më tepër, shpesh duket se është dërguar nga një kompani e mirënjohur, pasi që adresa e dërguesit përdor një emër domeni, që mund të jetë markë tregtare, që i ngjan emrit origjinal të domenit të asaj kompanie.

Sulmuesi shpesh do të ketë krijuar një faqe interneti lajthitëse, domethënë faqe në internet që është imitim i afërt i faqes zyrtare të internetit të një kompanie ose personi që imitohet, e mu për këtë, vizita në faqen e internetit në fjalë nuk ngjall ndonjë dyshim në lidhje me rrethanat keqdashëse.<sup>23</sup> Komunikimi fishing zakonisht përmban një vegëz (hyperlink) që lidh me faqen e internetit në fjalë, por faqja e internetit mund edhe të vizitohet ndaras. Në faqen e internetit, viktimës i kërkohet të shpalosë informata si ato të “azhurnuara” të kartës së kreditit, “konfirmimin” e fjalëkalimeve dhe informacione të ngjashme të ndjeshme.

Varësisht nga ajo që përdoruesi shtyhet të bëjë, veprime të tilla mund të rezultojnë në një ose më shumë vepra penale. Është mashtrim nëse sulmuesi arrin ta cytë viktimën të paguajë ndonjë shumë për një detyrim të paqenë, ose ndonjë produkt apo shërbim të paqenë. Nëse sulmi rezulton në instalimin e virusëve *ransomware*, kjo mund të karakterizohet si zhvatje, ndërsa instalimi i virusëve *malware* mund të jetë vandalizëm.

## **Uzarpimi kibernetik dhe përdorimet e tjera të emrave të domenit në shkelje të DPI-ve**

Uzarpimi kibernetik (cybersquatting) është regjistrimi dhe përdorimi i një emri domeni që është identik, ose tejet i ngjashëm e hutues me markën tregtare të tjetrit, si dhe ku regjistrimi dhe përdorimi është keqdashës, me qëllimin për të përfituar disi nga regjistrimi dhe përdorimi.<sup>24</sup>

---

<sup>23</sup>Shih Kapitullin 16 tek ‘Hulumtimi për modelet e biznesit virtual që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale’, EUIPO, 2016

<sup>24</sup>Definicioni i WIPO-së për uzarpimin kibernetik.

Një variacion i *uzurpimit kibernetik* është *uzurpimi gramatik (typosquatting)*, në të cilin rast një regjistruer përvetëson emrat e shkruar gabimisht të emrit të domenit të tjetrit, me qëllim që të tërheqë dhe të eksploatojë trafikun që është synuar për faqen fillestare (legjitime) të internetit.

Të dy fenomenet vazhdojnë të ndodhin në numër të madh,<sup>25</sup> gjë që mund të shpjegohet jo vetëm me implementimin e shumë domeneve të reja të nivelit të lartë gjenerik, si .xyz dhe .top, por edhe me zhvillimin e vazhdueshëm të mënyrave për të fituar të ardhura nga regjistrime të tilla si të ardhurat ‘paguaj për klikim’ dhe të ardhurat bazuar në skemat e reklamave partnere.<sup>26</sup>

## 4. LEGJISLACIONI

### 4.1 Hyrje

Një numër masash legislative janë miratuar në nivelin ndërkombëtar dhe kombëtar për të forcuar dhe harmonizuar mbrojtjen dhe zbatimin e DPI-ve, duke përfshirë mjedisin në internet. Këto masa përmbajnë dispozita që u mundësojnë bartësve të të drejtave dhe agjencive të zbatimit të ligjit, si policia, të zbatojnë efektivisht DPI-të.<sup>27</sup>

### 4.2 Marrëveshja TRIPS

Marrëveshja mbi aspektet e lidhura me tregtinë e të drejtave të pronësisë intelektuale (TRIPS) obligon 164 anëtarët e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) të sigurojnë standarde minimale të harmonizuara në lidhje me mbrojtjen dhe zbatimin e DPI-ve.<sup>28</sup> Në veçanti, marrëveshja TRIPS përmban dispozitat e mëposhtme të lidhura me zbatimin, të cilat janë të rëndësishme jo vetëm për mjedisin fizik, por edhe për atë në internet:

<sup>25</sup>WIPO Rriten shumë rastet e paraqitura për uzurpim kibernetik Gjatë COVID-19 në: [https://www.wipo.int/amc/en/news/2020/cybersquatting\\_covid19.html](https://www.wipo.int/amc/en/news/2020/cybersquatting_covid19.html)

<sup>26</sup>Shih përshkrimin e skemave të tilla për të ardhura tek paragrafi 5.3.2., tek ‘Hulumtimi për modelet e biznesit virtual që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale’, EUIPO, 2016.

<sup>27</sup>Shih pasqyrën e këtyre masave legislative më poshtë në Kapitullin 7.

<sup>28</sup>[https://www.wto.org/english/docs\\_e/legal\\_e/27-trips\\_01\\_e.htm](https://www.wto.org/english/docs_e/legal_e/27-trips_01_e.htm)



- Neni 47 - E drejta për të marrë informata mbi shkeljen dhe shkelësit;
- Neni 50 - Masat e përkohshme për të parandaluar shkeljet dhe për të ruajtur provat;
- Neni 51 - Pezullimi i lirimit të mallrave kundërvajtës nga autoritetet doganore; dhe
- Neni 61- Procedurat penale dhe ndëshkimet.

### 4.3 Konventa e Krimin Kibernetik

Konventa e Krimin Kibernetik, e cila është nënshkruar edhe nga vendet anëtare të BE-së edhe ato jo-anëtare, ka vendosur një numër mekanizmesh që janë me rëndësi për zbatimin e DPI-ve në mjediset virtuale. Konventa shprehimisht mbulon veprat penale në lidhje me shkeljen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqësuara, por jo objekteve të tjera të PI-së. Sidoqoftë, dispozitat për falsifikimin dhe mashtrimin në lidhje me kompjuterët mund të përfshijnë indirekt keqpërdorimin e markave tregtare të palëve të treta në skemat fishing.<sup>29</sup>

### 4.4 Legjislacioni vendor

Kosova ka miratuar një numër të instrumenteve legjislative që mund të përdoren për të luftuar dhe parandaluar shkeljet virtuale të DPI-ve.

#### Legjislacioni primar për DPI

Ligjet primare për DPI, zbatuar nga qeveria në Kosovë, janë:

- Ligji Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare (ndryshuar me ligjin nr. 05/L-040);
- Ligji nr. 05/L-058 për Dizajnet Industriale;
- Ligji nr. 04/L-029 për Patentat (ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-039);
- Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përfaqësuara (ndryshuar me ligjin nr. 05/L-047 dhe ligjin nr. 06/L-120);
- Ligji Nr. 02/L-098 për mbrojtjen e varieteteve të bimëve;

<sup>29</sup><https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/185>

- Ligji Nr. 05/L-051 për Indikacionet Gjeografike dhe Emërtimet e Origjinës; dhe
- Ligji Nr. 03/L-165 për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara.

Legjislacioni primar i DPI-ve përshkruan mënyrën e sigurimit të mbrojtjes së DPI-ve dhe shtrirjen e të drejtave ekskluzive që gëzohen nga bartësi i të drejtës, duke përfshirë faktin që bartësi i të drejtës mund të ndalojë palët e treta të përdorin DPI-të e tyre pa leje.

Shumica e dispozitave në legjislacionin primar të DPI-ve janë ‘neutrale në teknologji’, që do të thotë se dispozitat vlejné pavarësisht se cilat mjete teknologjike përdoren për të prodhuar krijimet e mbrojtura ose cilat mjete përdoren në ndonjë veprimtari kundërvajtëse, p.sh. Neni 8 (2) i Ligjit Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare thekson se bartësi i markës tregtare mund të ndalojë “përdorimin e shenjës në letrat e biznesit dhe në reklamim”. Kjo dispozitë nuk ka të bëjë vetëm me reklamat fizike por edhe për përdorimin e shenjës kundërvajtëse si emër domeni<sup>30</sup> ose AdWord<sup>31</sup>.

Legjislacioni primar i DPI-ve po ashtu përmban masa të zbatimit dhe mjetet juridike, të ngjashme me Marrëveshjen TRIPS, që janë në dispozicion të bartësve të së drejtës dhe agjencive të zbatimit të ligjit, duke përfshirë:

- E drejta për të marrë informata mbi shkeljen dhe shkelësit; dhe
- Masat e përkohshme për të parandaluar shkeljet dhe për të ruajtur provat.

## **Ligji për Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit**

Nenet 24 deri 26 të Ligjit Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit janë gjithashtu të një rëndësie të madhe në lidhje me zbatimin në internet të DPI-ve. Ligji mbi Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit përshkruan përgjegjësinë e ndërmjetësuesve të internetit, që përfshin përgjegjësinë e tyre në rastet kur shërbimet e tyre

<sup>30</sup>Rasti CJEU C-657/11, BEST v Visys.

<sup>31</sup>Rasti CJEU C-236/08 et al., Google v Louis Vuitton

përdoren për të shkelur të drejtat DPI. Në atë kontekst, Ligji për Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit funksionon me tri kategori të shërbimeve ndërmjetësuese, përkatësisht:

- ‘Përçim i thjeshtë’ - shërbim që konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit nga marrësi i shërbimit ose sigurimin e qasjes në një rrjet komunikimi;
- ‘Caching’ - shërbim që konsiston në transmetimin në një rrjeti të komunikimit informacioni për marrësin e shërbimit, duke përfshirë ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të këtij informacioni, ruajtjen e kryer me qëllimin e vetëm që ta bëjë më efikas transmetimin e informacionit tutje drejt marrësve të tjerë të shërbimit sipas kërkesës së tyre; dhe
- ‘hostingu’ - ruajtja e informacionit të ofruar nga marrësi i shërbimit.

Neni 28 i Ligjit Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit bazohet në parimin që ndërmjetësit nuk janë të detyruar të monitorojnë informacionin që ata dërgojnë ose ruajnë, dhe as nuk kanë detyrim të përgjithshëm të kërkojnë aktivisht fakte ose rrethanat që tregojnë veprimtari të paligjshme. Sidoqoftë, nëse ndërmjetësi i tillë ka fituar njohuri ose është bërë i vetëdijshëm për aktivitete të tilla të paligjshme, nga ndërmjetësi kërkohet të veprojë shpejt për të hequr ose për të çaktivizuar qasjen në informacion nëse dëshiron të qëndrojë brenda parashikimeve të “portit të sigurt” të Ligjit.

## **Kodi Penal**

Veprat ndaj DPI-ve të renditura në Kodin Penal (Ligji Nr. 06/L-074) janë:

- Neni 289 “Cënimi i të drejtave të patentës”;
- Neni 290 “Cënimi i të drejtave të autorit” ;
- Neni 291 “Shmangia e masave teknologjike”; dhe
- Neni 292 “Mashtrimi i Konsumatorëve” .

Formulimi aktual i veprave penale është riprodhuar në Shtojcën III.

## **Ligji për Zbatimin Doganor të DPI-ve**

Ligji Nr. 06/L-015 për Masat Doganore për Mbrojtjen e DPI-ve ofron rregullat procedurale për autoritetet doganore në zbatim të DPI-ve në lidhje me mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore ose kontrollit doganor në kufi. Nëse mallrat e tillë dyshohet se shkelin një DPI, lirimi i mallrave mund të pezullohet dhe mallrat mund të ndalohen nga autoritetet doganore në kufi nëse kërkesat e përcaktuara në Ligj janë përmbushur.

Ligji Nr. 06/L-015 për Masat Doganore është i zbatueshëm për mallrat që janë blerë dhe janë dërguar nga një lokacion jashtë Kosovës tek një klient brenda Kosovës, pavarësisht nëse blerja është kryer në internet ose ndryshe.

Megjithatë, zbatimi në fushën e Televizionit të paligjshëm me Protokoll Interneti (IPTV) paraqet sfida specifike. Kjo është për shkak se ndërsa pajisjet pranuese plotësisht të gatshme shkelin të drejtat e autorit dhe bien krejtësisht brenda fushës së veprimit doganor, pajisjet ‘e bardha’ (p.sh. Pajisjet pranuese që nuk janë konfiguruar ende për të marrë transmetim të paligjshëm) nuk çenojnë drejtpërdrejt ndonjë pronë intelektuale. Këto pajisje mund të shitën si të tilla për përdoruesit përfundimtarë, të cilët më pas i konfigurjnë ato duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga shitësi ose të gjetura në forume dhe grupe diskutimi. Sidoqoftë, pajisjet ‘e bardha’ të prodhuara nga biznese të dyshimta mund të paraqesin tipare të rrezikshme që i bëjnë ato të paligjshme sipas standardeve të sigurisë.


## **5. MASAT PËR ZBATIMIN E DPI-VE NË INTERNET**

### **5.1 Hyrje**

Prodhimi, tregtimi, shpërndarja dhe shitja e mallrave të paligjshme të tilla si softueri pirat ose brendet e falsifikuara janë sipas definicionit akte të paligjshme. Siç është thënë më lart, legjislacioni i zbatueshëm për PI i ofron bartësit të drejtën ekskluzive për produktet origjinale. Tradicionalisht, bartësi i së drejtës mund të ndjekë prodhuesin, shpërn-

darësin ose shitësin e mallrave që shkelin DPI-të përmes gjykatës ose sistemit administrativ. Sidoqoftë, veprime të tilla janë të ndërlikuara kur përdoren mjediset virtuale për të shkelur DPI-të. Si pasojë, bartësit e të drejtave dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, përfshirë policinë, kanë kërkuar mënyra të tjera për të ndjekur shkeljet e DPI-ve në mjedisin virtual ndërkufitar. Ky zhvillim ka çuar në një situatë ku ndërmjetësit e ndryshëm në internet janë bërë ‘pika të natyrshme kontrolli’ kur bëhet fjalë për zbatimin e DPI-ve.

Ndërmjetësit në internet kanë fituar rol të rëndësishëm në menaxhimin e sjelljes në internet dhe respektimin e të drejtave të përdoruesve të internetit. Këta ofrojnë një pikë të natyrshme kontrolli për monitorimin, filtrimin, bllokimin dhe çaktivizimin e qasjes në përmbajtje, gjë që i bën ata partnerë idealë në përmbardimin civil, administrativ dhe penal të DPI-ve.<sup>32</sup>



**Figura 1 - Shembuj të ndërmjetësuesve në internet<sup>33</sup>**

Siç është theksuar tek Kapitulli 4, një numër masash legislative janë miratuar në nivelin ndërkombëtar dhe atë kombëtar për të forcuar dhe harmonizuar mbrojtjen dhe zbatimin e DPI-ve duke përfshirë mjedisin në internet. Këto masa përmbajnë mjete juridike, të cilat synojnë t'u

<sup>32</sup>Citat nga f. 9 në Perel Filmar, Maayan dhe Elkin-Koren, Niva: Përgjegjësia në Zbatimin Algoritmik të të Drejtave të Autorit (Accountability in Algorithmic Copyright Enforcement - 21 shkurt 2016. Revista e të Drejtës Teknologjike Stanford (Stanford Technology Law Review), Forthcoming. Gjetet tek: SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2607910> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2607910>

<sup>33</sup>Studimi mbi Masat Legislative në lidhje me Shkeljet në internet të DPI-ve, EUIPO, 2018.

mundësojnë bartësve të të drejtave dhe agjencive të zbatimit të ligjit, si policia, të zbatojnë efektivisht DPI-të, përfshirë:

- Marrjen e informatave të llogarisë;
- Bllokimin e qasjes në faqet e internetit;
- Veprimet me emrin e domenit; dhe
- Veprimet që shënjestrojnë mbajtësit e domeneve (host).

Përveç masave specifike legislative që janë miratuar për të forcuar dhe harmonizuar mbrojtjen e DPI-ve në mjedisin virtual, masat tradicionale, të tilla si tek pastrimi i parave, nuk duhet të neglizhohen ose harrohen nga hetuesia.


## 5.2 Marrja e informatave të llogarisë

Përcaktimi i identitetit të një shkelësi të dyshuar të DPI-ve është i ndërlikuar kur bëhet fjalë për mjedisin virtual, pasi identiteti i shkelësit të dyshuar nuk është lehtësisht i disponueshëm.

Kur transmetohen (stream) materiale të mbrojtura me të drejtën e autorit, si muzika e gjallë, ngjarjet sportive dhe shpërndarja e skedarëve që përmbajnë vepra të mbrojtura me të drejtat e autorit, si filmat dhe muzika, shpesh është e mundur të përcaktohet IP-adresa që është përdorur për aktivitetet kundërvajtëse. Sidoqoftë, kërkohen veprime të mëtejshme hetimore për të përcaktuar identitetin e subjektit që ka përdorur adresën e veçantë IP në ekzekutimin e një shkeljeje të DPI-ve. Për më tepër, kundërvajtësi i pretenduar mund të fshehë adresën e tyre IP me mjete teknike ose të përdorë një IP-adresë të tretë.

Nëse veprimtaria kundërvajtëse bëhet në faqe të dedikuara të internetit, ose në ndonjë platformë të tretë të internetit, si tregu virtual ose platforma e mediave sociale, mund të arrihet të identifikohet 'llogaria' e shkelësit të pretenduar. Ndërsa identifikimi specifik i bartësit të llogarisë nuk është lehtësisht i mundshëm për palët e treta, informacioni i tillë është privat për operatorin e tregut ose platformën e mediave sociale.

Faqet e internetit që përdoren për të promovuar ose për të shpërndarë produkte ose shërbime që dyshohet se shkelin DPI-të e palës të tretë rrallë - nëse ndodh ndonjëherë - përmbajnë informacion të vërtetë dhe të besueshëm për palën që kontrollon faqen, as në formën e impresumit, e as në formën e informatave të tjera kontaktuese. Regjistrat e domeneve mbajnë databaza publikisht të disponueshme WHOIS të të regjistruarve, por saktësia e informacionit në këto databaza varet në masë të madhe nga saktësia e informacionit që ofrohet nga të regjistruarit, e këto nuk janë gjithmonë të vërteta dhe të sakta.<sup>34</sup> Për më tepër, në fusha të caktuara të nivelit të lartë, të regjistruarit e një emri domeni mund të mbështetet në përdorimin e një shërbimi privatësie apo prokure (proxy), që fsheh identitetin e të regjistruarit të vërtetë në regjistrin WHOIS.



Prandaj është e rëndësishme - dhe në shumicën e rasteve qenësore - të përcaktohet nëse një ndërmjetës interneti, shërbimet e të cilit përdoren nga një prej klientëve të tyre për të kryer veprimtari shkelëse

<sup>34</sup>Çështja e informacionit të rremë të kontaktit përmendet disa herë në Pasqyrën e Pamjeve të Panelit WIPO mbi Pyetjet e Zgjedhura UDRP (Politika e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve për Emrin Uniform të Domenit), Botimi i Tretë, gjendet tek: <<http://www.wipo.int/amc/en/domains/search/overview3-0/>>. Shih, si shembull ilustrues, Nenin 6B në Rastin WIPO DNL2017 <Dr. Martens <International Trading GmbH /> Dr. Maertens Marketing GmbH v Olga Olga <në emrin e domenit <doktermartens.nl>>.

<sup>35</sup>Studimi mbi Masat Legjislative në lidhje me Shkeljet virtuale të DPI-ve, EUIPO, 2018.

të DPI-ve mund të urdhërohet të shpалosë informata mbi identitetin e klientit që ka në posedim.

## **Shpалosja e identitetit të bartësit të një llogarie të caktuar**

E drejta e informimit në rastet e shkeljes së DPI-ve parashihet në legjislacionin primar për DPI-të, p.sh. në nenin 100 të Ligjit nr. 04/L-026 për markat tregtare. Si shembull, sipas kësaj dispozite, autoritetet gjyqësore kompetente mund të urdhërojnë cilindo që është përfshirë në një shkelje të DPI-ve të shpалosë:

- Informatat për emrat dhe adresat e prodhueseve, shpërndarësve, furnitorëve dhe pronareve të tjerë të mëparshëm të produkteve dhe shërbimeve, shitësve me shumicë dhe pakicë; si dhe
- Informatat për sasi të prodhuara, shpërndara, pranuar dhe porositura, si dhe çmimin për produktet dhe shërbimet.

Në hetimet penale, policia dhe/ose prokurori mund të paraqesin kërkesë tek autoriteti gjyqësor kompetent për të urdhëruar ndërmjetësin e internetit të shpалosë informata të tilla të llogarisë, nëse kërkesa plotëson kriteret e përgjithshme procedurale për të qenë ‘të arsyetuara dhe proporcionale’.

## **Informata kontakti për bartësin e një llogarie të caktuar**

Në lidhje me informacionin e kontaktit për bartësin e një llogarie specifike në rrjetin ose platformën virtuale, si rrjeti i mediave sociale ose tregu digjital, është e mundur që në procedurë civile të merret vendimi gjyqësor që urdhëron ofruesin e shërbimit në internet të shpалosë atë informacion.

Në hetimet penale, policia dhe/ose prokurori mund të paraqesin kërkesë tek autoriteti gjyqësor kompetent për të urdhëruar ndërm-



jetësin e internetit të shpalosë informata të llogarisë për klientë të caktuar.

## **Informatat e kontaktit për subjekte që përdorin IP-Adresë për Aktivitete që Shkelin DPI-të**

Sa i përket informatave të kontaktit për një person apo subjekt që përdor IP-adresë ose e vë në dispozicion serverin me IP-adresë të siguruar nga ofruesi i tij i qasjes, pasqyra e përgjithshme është e njëjtë me atë të informacionit të lartpërmendur të llogarisë: Është e mundur që në Kosovë të shfrytëzohet e drejta civile për të nxjerrë aktvendim gjyqësor që urdhëron ofruesin e shërbimit virtual të shpalosë këtë informacion.

Në hetimet penale, policia dhe/ose prokurori mund të parashtrojnë kërkesë tek autoriteti gjyqësor kompetent për të urdhëruar ndërmjetësin e internetit të shpalosë informacionin e kontaktit të një personi ose një subjekti që përdor IP-adresë ose vë në dispozicion serverin me IP-adresë të ofruar nga ofruesi i tij i qasjes.

## 5.3 Bllokimi i qasjes në faqet e internetit

### Hyrje

Nëse aktiviteti që shkel DPI-të zhvillohet në ose përmes një faqeje të dedikuar interneti, një mënyrë efektive për të penguar aktivitetet aktuale dhe për t'i parandaluar ato që të ndodhin në të ardhmen është bllokimi i qasjes në faqen e internetit. Kështu, urdhrat e bllokimit janë bërë mjet juridik i importuar që përdoret shpesh si nga bartësit e të drejtave ashtu edhe nga policia/prokurorët.

Një arsye tjetër për efektivitetin dhe popullaritetin e kësaj mase është se shënjestra e një urdhri bllokimi janë ofruesit e ndryshëm të qasjes, që ofrojnë qasje teknike në internet. Këta ofrues janë kompani të njohura që mund të identifikohen menjëherë, e në këtë mënyrë të jenë subjekt i veprimeve ligjore.

Megjithatë, bllokimi i qasjes në një faqe interneti është masë e kufizuar dhe e shënjestruar ligjore. Faqja e internetit si e tillë do të vazhdojë të ekzistojë, si dhe mund të jetë e qasshme për ata përdorues të internetit, ofruesi i qasjes së të cilëve nuk mbulohet me urdhër bllokimi, përfshirë ofruesit në juridiksione të tjera.

Gjykatat e Kosovës kanë juridiksion vetëm për çështjet që kanë të bëjnë ose kanë efekt në territorin e Kosovës. Kështu, urdhrat e bllokimit mund të lëshohen si pikë fillestare vetëm nëse veprimtaritë në faqen e internetit në fjalë shkelin ose mund të shkelin DPI-të që janë të mbrojtura në Kosovë.<sup>36</sup>

### Përgjegjësia e ndërmjetësuesve

Rregulli i përgjithshëm për përjashtimin e përgjegjësisë së ofruesve të qasjes parashihet në nenin 24(1) të Ligjit 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit, ku kuptohet që ofruesi i qasjes nuk është përgjegjës për informacionin që dërgohet nga klientët, nëse plotësohen disa kushtet të specifikuar. Kjo dispozitë që quhet “port i sigurt”

<sup>36</sup>Rasti CJEU C-324/09, L’Oreal v eBay.

megjithatë, nuk ndikon në mundësinë që gjykatat ose autoritetet administrative të kërkojnë që ofruesit e qasjes të ndërpresin ose parandalojnë shkeljet. Nga kjo rrjedh se bartësit e të drejtave dhe agjencitë e zbatimit të ligjit janë në gjendje të kërkojnë masë të përkohshme kundër ndërmjetësuesve, shërbimet e të cilëve përdoren nga palë të treta për të shkelur DPI-të.

## **Masat e përkohshme bllokuese**

Masa e përkohshme bllokuese është urdhër gjykate që një ofrues qasjeje të bllokojë qasjen e përdoruesve në një listë të caktuar të faqeve të internetit. Këto masa të përkohshme janë dëshmuar të jenë më efektive sesa urdhrat apo kërkesat që ofruesit e shërbimeve të hostingut të çaktivizojnë faqet kundërvajtëse të internetit. Kjo është për shkak se operatorët e këtyre faqeve të internetit mund të lëvizin lehtësisht tek një shërbim tjetër hostingu, si dhe të lëvizin prapë drejt juridiksioneve të huaja, të cilat nuk u përgjigjen kërkesave të njoftimit dhe çaktivizimit. Në të kundërt, masat e përkohshme bllokuese ndaj ofruesve të qasjes në internet e bëjnë faqen e internetit të padisponueshme për përdoruesit në vendin ku jepet urdhri, pavarësisht nga hosti ku gjendet faqja e internetit.<sup>37</sup>

## **Masat e përkohshme dinamike bllokuese**

Masat e përkohshme bllokuese mund të specifikojnë jo vetëm emrin e domenit dhe IP-adresën e faqes(ve) së internetit për të bllokuar qasjen, por edhe çdo emër tjetër domeni, në të cilin kryhen shkeljet e lidhura me të njëjtat të drejta. Masat e tilla ‘dinamike’ rrisin efikasitetin e bllokimit të qasjes në faqe interneti dhe mundësojnë parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

## **Masat e përkohshme bllokuese “live”**

Masat e përkohshme bllokuese mund të funksionojnë duke obliguar ofruesit e qasjes të bllokojnë qasjen e përdoruesve në serverat që janë host për transmetimet kundërvajtëse të organizimeve të drejtpërdre-

---

<sup>37</sup>CJEU në rastin UPC Telekabel (Rasti C-314/12) ka konstatuar këtë lloj mase të përkohshme të jetë e pajtueshme me të drejtën e BE-së, me kusht që të mos privojnë përdoruesit e internetit nga mundësia e qasjes së ligjshme në informacionin e disponueshëm dhe ato kanë efekt të parandalimit (ose të vështirësimit) të qasjes në përmbajtje kundërvajtëse.

jta sportive. Të ashtuquajturat masa të përkohshme ‘drejtpërdrejt’ të bllokimit janë sidomos të efektshme në ballafaqim me shërbimet IPTV të paligjshme, sepse shënjestrojnë posaçërisht serverat që transmetojnë përmbajtje të paligjshme gjatë transmetimit të ngjarjeve të drejtpërdrejta.

## Masat e përkohshme me de-indeksim

Këto masa të përkohshme kërkojnë nga motorët e kërkimit të de-indeksojnë faqet kundërvajtëse të internetit, ashtu që vegëzat e atyre faqeve të mos shfaqen në listën e rezultateve të kërkimit.

## 5.4 Veprimet me emër domeni

### Hyrje

Siç është përmendur në Kapitullin 3, emrat e domeneve luajnë rol kryesor në lloje të ndryshme të shkeljeve të DPI-ve në mjedisin virtual, duke përfshirë uzurpimet kibernetike dhe skemat phishing.

Emrat e domeneve përdoren gjithashtu si adresa interneti për faqet që përmbajnë përmbajtje kundërvajtëse, duke përfshirë faqet me vegëza drejt përmbajtjeve të paligjshme digjitale, faqe që kontribuojnë në transmetimin e videos dhe faqet e internetit me torrentë.<sup>38</sup> Në këto situata nuk është emri i domenit si i tillë që bën shkelje, por përmbajtja e faqes në internet.

Nëse një emër domeni përdoret për aktivitete që shkelin DPI-të, gjykata mund të urdhërojë kundërvajtësin të ndërpresë aktivitetet shkelëse nën emrin e domenit, por po ashtu, gjykata mund të shqiptojë kompensim dëmsh, gjoba dhe sanksione të tjera civile, administrative apo penale.

Në vitet e fundit, agjencitë e zbatimit të ligjit në një numër vendesh kanë siguruar vendime gjyqësore të cilat kanë sekuestruar një numër të madh të emrave të domeneve. Më e dukshmja është “Operacioni

---

<sup>38</sup>Shih modelet e biznesit të përshkruara në kapitujt 21, 22, 23, dhe 25 tek ‘Hulumtimi për modelet e biznesit virtual që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale’, EUIPO, 2016.

në faqet tona” që koordinohet nga Europol-i<sup>39</sup> dhe ka sekuestruar 10,000,000 emra domenesh që janë përdorur si adresa interneti për faqet e internetit që shkelin DPI-të.

Baza ligjore që zbatohet për të sekuestruar emrat e domeneve është zakonisht tek dispozitat e përgjithshme për konfiskimin. Sidoqoftë, meqenëse një emër domeni nuk është mall fizik që mund të ndalohet, sekuestrimi përfshin urdhrin për të siguruar që emrat e domenit të mos barten, fshihen apo ndryshe lirohen.

## 5.5 Veprimet me shënjestër nikoqirin (Host)

### Hyrje

Siç është theksuar më lart tek pika 5.1, ndërmjetësit e ndryshëm në internet janë bërë ‘pika të natyrshme kontrolli’ kur bëhet fjalë për zbatimin e DPI-ve. Kjo sidomos vlen për ata ndërmjetës që veprojnë si host - kompani që operojnë me platforma interneti, nga të cilat ose në të cilat zhvillohen aktivitete që shkelin DPI-të. Shembuj të nikoqirëve të tillë janë tregjet digjitale<sup>40</sup> dhe platformat e mediave sociale.<sup>41</sup>

### Përgjegjësia e ndërmjetësuesve

Rregulli i përgjithshëm për përfshirimin e përgjegjësisë së ofruesve të hostingut parashihet në nenin 26(1) të Ligjit 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit, ku kuptohet që ofruesi nuk është përgjegjës për informacionin që ruhet nga klientët, nëse plotësohen kushte të specifikuara. Kjo dispozitë që quhet “port i sigurt” megjithatë nuk ndikon në mundësinë që gjykatat të kërkojnë që ofruesit e hostingut të ndërpresin ose parandalojnë shkeljet e DPI-ve.

<sup>39</sup><https://www.europol.europa.eu/activities-services/europol-in-action/operations/operation-in-our-sites-ios>

<sup>40</sup>Shih kapitullin 8 Mallrat e marketingut ose përmbajtja digjitale në tregun virtual me shumicë të palëve të treta (B2B) tek ‘Hulumtim për modelet e biznesit në internet që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale. Faza 1 Përcaktimi i pasqyrës së modeleve të biznesit në internet që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale’, EUIPO, korrik 2016.

<sup>41</sup>Shih Kapitullin 9, Shitja e Mallrave Jo-Origjinale përmes Rrjeteve të Mediave Sociale, tek ‘Hulumtim për modelet e biznesit në internet që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale. Faza 1 Përcaktimi i pasqyrës së modeleve të biznesit në internet që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale’, EUIPO, korrik 2016.

Rrjedhimisht, ka disa procedura që mund të iniciohen ndaj ndërmjetësve që veprojnë si nikoqirë (host), përfshirë:

- Çaktivizimin e shitjeve apo reklamave për mallrat që shkelin DPI-të; dhe
- Bllokimi i llogarive të përdorura për shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve që shkelin DPI-të.

## Çaktivizimi i shitjeve apo reklamave për mallrat që shkelin DPI-të

‘Çaktivizimi’ në fillim është procedurë përmes së cilës një palë e tretë mund të parashtrojë ankesë (‘njoftim’) tek operatori i një tregu virtual, një platforme të mediave sociale ose një platforme të ngjashme, si dhe të kërkojë që operatori i platformës të heqë (‘çaktivizojë’) produktin që ofrohet për shitje ose reklamohet në treg nga një palë e tretë. Pastaj, është operatori individual i platformës në fjalë që vendos nëse do të pranojë ose të refuzojë ankesën, domethënë, nëse do të çaktivizojë listimin kundërvajtës apo jo.

Procedurat e tilla të ‘Njoftimit dhe Çaktivizimit’ zbatohen dhe aplikohen nga shumica e tregjeve digjitale, si dhe nga shumica e platformave të mediave sociale, si dhe janë pjesë përbërëse të kushteve dhe afatëve të vetë platformës. Në shumë vende, procedurat e ‘Njoftimit dhe çaktivizimit’ përdoren në numër të madh çdo ditë, si dhe përgjithësisht perceptohen si vegla efikase kur bëhet fjalë për zbatimin e DPI-ve në mjedisin virtual.<sup>42</sup>

Sidoqoftë, nëse operatori refuzon të veprojë, jo vetëm që bëhet përgjegjës për shkeljen e DPI-ve, por është e mundur edhe të kërkohet urdhri i gjykatës që detyron operatorin të veprojë.

---

<sup>42</sup>Strategji digjitale e tregut të përbashkët për Evropën’, Komunikatë nga Komisioni Evropian, 6 maj 2015, COM(2015) 192 finale, Pika 3.3.2., f. 12; ‘Komunikimi në Platforma virtuale dhe Tregu i Përbashkët Digjital’ {COM(2016) 288}, Pika 5.11), f. 7 ff

## **Blokim i llogarive që janë përdorur për shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve kundërvajtëse**

Përveç çaktivizimit të mundshëm të ofertave për shitje apo reklamave aktuale, pala e tretë mund të parashtrijë ankesë tek operatori i tregut virtual, platformës së mediave sociale ose platformës së ngjashme, si dhe të kërkojë nga operatori i platformës të bllokojë ose pezullojë llogarinë e përdorur për të shpërndarë mallra dhe shërbime që shkelin DPI-të. Pastaj, është operatori individual i platformës në fjalë që vendos nëse do të pranojë ose të refuzojë ankesën.

Sidoqoftë, nëse operatori refuzon të veprojë, jo vetëm që bëhet përgjegjës për shkeljen e DPI-ve, por është e mundur edhe të kërkohet urdhri i gjykatës që detyron operatorin të veprojë.

### **5.6 Pastrimi i parave**

Shkeljet e DPI-ve në shkallë komerciale si definicion kanë të bëjnë me fitimin e parave, si dhe siç thuhet në pikën 1.4, paratë që qarkullojnë në aktivitetet shkelëse të DPI-ve janë të mëdha.<sup>43</sup>

Qasja ‘përcill paranë’ konsiderohet si mjet i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve të paligjshme, duke përfshirë shkeljet e DPI-ve. Kjo qasje jo vetëm që u mundëson autoriteteve identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e parave, por i mundëson, ose së paku lehtëson, edhe identifikimin e autorëve.

Rasti suedez SweFilmer<sup>44</sup> ilustron se si mund të përdoren qasja hetimore ‘përcill paranë’ dhe masat e pastrimit të parave për të hetuar shkeljet e DPI-ve. Në rastin SweFilmer, transmetimi i veprave audio-vizuale të palicencuara dhe veprat primare të pastrimit të parave ishin qenësore në hetim. I pandehuri kryesor u akuzua më vonë si për shkelje të së drejtës së autorit ashtu edhe për pastrim parash. Çështja përfundoi në shkallën e parë me aktgjykim fajësues, duke çuar në dënim mbajtjeje, si dhe kompensim dëmsh për bartësit e të drejtave.

<sup>43</sup>Trendet e tregtisë me mallra të falsifikuar dhe Pirate, EUIPO dhe OECD, 2019.

<sup>44</sup>Rasti Nr. T-1463-15 në Gjykatën Rajonale Varberg dhe Gjykatën e Apelit Göta, Rasti Nr. B 1565-17, 22 Shkurt 2018.

Neni 302 i Kodit Penal të Kosovës dhe Ligji mbi Parandalimin e Pas-trimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit e përkufizojnë pastrimin e parave si vepër penale në Kosovë.

## 6. MASAT E ZBATIMIT VULLNETAR

### 6.1 Hyrje

Meqenëse bartësit e të drejtave dhe agjencitë e zbatimit të ligjit nuk mund të arrijnë të hetojnë dhe të fillojnë veprime ligjore kundër çdo shkelje të DPI-ve në internet, ata kanë kërkuar zgjidhje të tjera për të penguar aktivitetet e shkelësve të DPI-ve, të tilla si Praktikat e Bashkëpunimit Vullnetar (VCP).

VCP-të kanë për qëllim të respektojnë ligjin dhe të drejtat themelore të qytetarëve, ndërsa luftojnë shkeljet e DPI-ve, përfshirë shkeljet virtuale të DPI-ve. VCP-të zakonisht përbëhen nga kode të sjelljes dhe praktikave që synojnë çaktivizimin e faqeve që shkelin DPI-të, largimin e reklamave nga faqet shkelëse të DPI-ve ose mohimin e qasjes së faqeve që shkelin DPI-të në sistemet e pagesave elektronike.

VCP-të zakonisht kanë disa pika të përbashkëta, posaçërisht:

- Janë vullnetare dhe prandaj nuk shqiptojnë sanksione të detyrueshme për mosrespektimin e detyrave dhe procedurave të parashikuara prej tyre;
- Ata vendosin masa parandaluese dhe/ose proaktive në mënyrë që të ndalojnë ose të zbulojnë shkeljet e pronës intelektuale; dhe
- Shumica e VCP-ve nuk përmbajnë ndonjë kosto apo tarifë për palët e interesit.



## 6.2 Shembull i masës së zbatimit vullnetar

Si shembull, në Austri, pas konsultimit me bartësit e të drejtave, Industria Austriake e Reklamimit (Werberat) hartoi një VCP si pjesë e Kodit të tyre vetë-rregullues të "Etikës për Industrinë Austriake të Reklamimit".

Sipas kësaj VCP-je austriake, është në kundërshtim me parimet e reklamimit vendosja e një reklame në një mjedis të paligjshëm, siç është faqja kundërvajtëse e internetit.

Në praktikë, me pranimin e ankesës nga një bartës i të drejtës ndaj një reklame, Werberat-i kryen një hetim preliminar. Nëse Werberat-i e konsideron ankesën të arsyeshme, ajo lëshon kërkesë për agjencinë përgjegjëse të reklamimit, ose reklamuesin, që të rishikojë reklamën brenda tre ditësh pune. Kërkesat e Werberat-it nuk janë ligjërisht obligative, ndërsa Werberat nuk mund të sanksionojë shkeljet e së drejtës së autorit.

Nëse reklamuesi pranon të largojë reklamën, nuk ndërmerret asnjë veprim tjetër. Sidoqoftë, nëse reklamuesi e konsideron ankesën e bartësit të së drejtës të pabazuar, ankesa dhe bazat e mospajtit të reklamuesit i dërgohen Senatit të Vogël (të reklamuesve) për vendim.

Shumica dërrmuese e reklamuesve largojnë reklamën në fjalë pa ju referuar Senatit të Vogël, duke privuar kështu shkelësin nga të ardhurat.<sup>45</sup>

Në Kosovë, bartësit e të drejtave dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, përfshirë policinë, duhet të punojnë me ndërmjetësit për të hartuar VCP të tilla në parandalim të shkeljeve virtuale të DPI-ve.

---

<sup>45</sup>Studim mbi praktikat e bashkëpunimit vullnetar në adresimin e shkeljeve në internet, EUIPO, 2016.

## 7. HETIMET VIRTUALE

### 7.1 Hyrje

Hetimet zakonisht iniciohen nga bartësit e të drejtave, të cilët nganjëherë iu ofrojnë autoriteteve dosje të plotë të hetimeve private, duke përfshirë deklarata, fotografi dhe vëzhgime.

Rëndësia e kontributeve të tilla gjithëpërfshirëse nga bartësit e të drejtave duhet të theksohet, pasi ndihmon për të siguruar mbikëqyrje me performancë të lartë, përmes ndarjes efikase dhe efektive të burimeve. Për shembull, nëse bartësit e të drejtave bien dakord *a priori* mbi strukturën, mënyrën dhe formatin e një dosjeje hetimore, kjo do të rezultojë në një qasje të koordinuar dhe homogjene, duke i mundësuar agjencive të zbatimit të ligjit të kryejnë hetime më efektive dhe më të harmonizuara.

Për më tepër, siç është diskutuar më parë, për të kapërcyer kufijtë legjislativë në lidhje me ligjet e pronës intelektuale, hetuesit duhet të kenë parasysh se mund të kryhen edhe vepra të tjera që shpesh paraqesin mundësi për të ndjekur penalisht pa pasur nevojë për vështirësitë komplekse në marrjen e deklaratave të të drejtave etj. Për shembull, shkeljet e DPI-ve mund të përfshijnë edhe vepra penale të:

- Pastrimit të parave;
- Evazionit fiskal;
- Planifikimi kriminal;
- Reketit;
- Mashtrimi (dhe planifikimi për mashtrim); dhe
- Vepra të tjera.

Pavarësisht, **hapi i parë** kritik në hetimin e shkeljes virtuale të DPI-ve - si në çdo hetim tjetër penal - është sigurimi i njohurive për legjislacionin përkatës dhe shqyrtimi se çfarë duhet për të pasur ndjekje penale që çon në një përfundim të suksesshëm.

Për më tepër, në lidhje me shkeljet e DPI-ve në internet, ekzistojnë tre metodologji kryesore që hetuesit mund të përdorin, të ndara ose në kombinim:

- “Përcille Transmetimin”;
- “Përcilli Paratë”; dhe
- “Përcille Pikselin”.

## 7.2 Hetimi “Përcille Transmetimin”

“Përcille Transmetimin” ka të bëjë me identifikimin e vetë përmbajtjes pirate nga konsumatori e deri te burimi i saj. Është detyrë e mundimshme të hetohet e të identifikohet çdo rrjet i veçantë kriminal që nga fillimi deri në fund (rrjedha e plotë), pasi kjo mund të përfshijë jo vetëm identifikimin e gjithë ekosistemit pirat labirint, që ndërlihdh një shumësi palësh - si të ligjshme ashtu edhe të paligjshme, por edhe tejkalimin e teknologjive të anonimizimit që përdoren nga shumë shkelës të ligjit për të fshehur gjurmët e aktiviteteve të tyre të paligjshme për të ofruar përmbajtjen pirate. Përkundër kësaj, jo të gjithë shkelësit e DPI-ve kanë njohuritë kompjuterike e as kujdesin e duhur për të eliminuar gjitha gjurmët dhe për të fshehur efektivisht gjurmët e tyre digjitale. Rrjedhimisht, hetuesit duhet të përpiqen të mbledhin me kujdes të dhëna dhe indicie të ndryshme (qoftë në formë digjitale ose fizike) nga shumë burime, si dhe të jenë vigjilentë për hetimet paralele që mund të lindin.

## 7.3 Hetimi “Përcille Paranë”

Dobia financiare është motivi dominues në shumë aktivitete të krimit kibernetik, e shkeljet e DPI-ve nuk bëjnë përjashtim. Si pasojë, kur palët e përfshira janë të pakapshme, një e dhënë tjetër e mundshme është gjurma e parave. Me ndjekjen e gjurmës së parave, mund të përvijohet i gjithë operacioni i shkeljes së DPI-ve. Ndërsa kriminelët përpiqen të fshehin identitetin e tyre dhe gjurmët e tyre digjitale, paratë që ata shkëmbejnë shpesh janë të vështira të fshihen, si dhe të vështira të hiqen nga dora. Megjithëse monedhat elektronike, digjitale, virtuale dhe kripto-valutat (si Bitcoin dhe Monero) potencialisht mund të ofrojnë nivel më të lartë të fshehtësisë dhe anonimitetit, transaksionet e kryera prapë mund të jenë të gjurmueshme, në parim.

Për më tepër, kur shfrytëzohen ofruesit e pagesave, si kartat e kreditit ose PayPal, detajet e llogarive të vegëzave mund të shpalosen për autoritetet, në pajtim me legjislacionin vendor. Për më tepër, autoriteti bankar mund të urdhërohet të bllokojë një llogari. Nga ajo pikë, çdo qasje ose përpjekje për të qasur paratë mund të zbulojë gjurmë dhe prova të vlefshme, si IP-adresa e përdorur për hyrje në faqen e internetit, tek ofruesi i pagesës ose shërbime të tjera.

Në qendër të çdo hetimi financiar qëndron identifikimi i transaksionit dhe analiza e pagesave për shërbimet e paligjshme. Pajisjet digjitale të sekuestruara nga operacioni i zbatimit të ligjit mund të zbulojnë prova të abonimeve që çojnë në informacionin e klientit, duke përfshirë mënyrën dhe kohën kur palët e paligjshme kanë paguar për shërbimet e tyre dhe koston përfundimtare të shërbimeve të ofruara. Analiza e dosjeve të postës elektronike dhe artefakteve të tjera digjitale mund të çojë në identifikimin e llogarive bankare, pagesave për shërbime, qarkullime parash, si dhe të sigurojë prova drejt marrjes së shifrave të qarkullimit të biznesit.

Parimi themelor që duhet pasur parasysh është që ndërsa paratë janë motivi, hetuesit duhet të përpiqen të hulumtojnë mekanizmin e transferimit të parave që përdoret, si dhe të përpiqen ta pengojnë atë. Me pengimin e rrjedhës së parave, palët e përfshira mund të detyrohen, kohë pas kohe, të bëjnë ndonjë lëvizje të dëshpëruar, e cila potencialisht mund të rrisë gjasat për të bërë gabime. Prandaj, “Përcilli Paratë” është pistë e dobishme hetimi dhe mund të çojë në identifikimin e të dyshuarve ose personave me interes.

Shkurt, ekzistojnë dy pyetje që, nëse marrin përgjigje, kanë potencialin të zbulojnë një pjesë të madhe të rrjetit të shkeljeve të DPI-ve:

Pyetja “Kush paguan?”:

- Kush paguan për emrin e domenit? (Ky informacion është në dispozicion në organizatën e nivelit të lartë të domeneve);
- Kush paguan për shërbimin e hostingut? (Ky informacion është në dispozicion tek ofruesi i hostingut); dhe

- Kush paguan për serverin e Sistemit/Regjistrin të Emrave të Domeneve (DNS)? (Ky informacion është në dispozicion tek ofruesi i shërbimit DNS).

Pyetja “Ku shkojnë paratë?”:

- Nëse ka përpunues pagesash të instaluar në faqen pirate të internetit (PayPal, Visa, etj.), ky informacion është i disponueshëm tek kompania e caktuar për të trajtuar transaksionet e kartave të kreditit; dhe
- Nëse ka pagesa mobile të instaluar në aplikacionin e shkelësit, ky informacion është i disponueshëm nga ofruesi i telekomit mobil.

## 1.4 Hetimi “Përcille pikselin”

Termi “Përcille Pikselin” përdoret për të mbuluar të gjitha teknologjitë që lidhen me reklamat virtuale, të cilat tashmë janë pjesë përbërëse e shërbimeve të bazuara në internet. Termi ‘piksel’ në mediat sociale dhe botën e marketingut virtual i referohet teknologjive mundësuese të përdorura për implementimin e fushatave të marketingut në internet, duke përfshirë kapacitetin për raportimin e efektivitetit të tyre, si dhe për shpërndarjen e të ardhurave të krijuara midis palëve të përfshira. Meqenëse aktivitete të tilla kërkojnë identifikimin e përfituesve, kjo pistë hetimi është shumë përkrahëse dhe komplementare ndaj metodave “Përcille rrjedhën” dhe “Përcilli Paratë”.

Faqet që shkelin DPI-të dhe aplikacionet mobile janë të mbështetura kryesisht në reklama, edhe pse disa kanë zbatuar modele abonimi, ndërsa të tjerët pranojnë donacione nga përdoruesit. Si pasojë, të ardhurat e paligjshme mund të vijnë jo vetëm nga abonimet dhe donacionet, por në formën e të ardhurave nga reklamat, të krijuara nga pagesa për klikim, pagesat nga shkarkimet dhe pagesa në lidhje me reklama (banner) të shfaqura në faqet e internetit.

Ky proces mundësohet nga ndërmjetësuesit e reklamave dhe reklam-  
at mund të jenë të dukshme në faqet aktuale të internetit, shfaqen në  
skeda të ndara kur përdoruesi klikon në pjesë të caktuara të faqes së  
internetit ose përmes “mbushjes me pikselë” - e cila arrihet nga përf-  
shirja e Hapësirave të vogla Reklamuese (Ad Space - 1x1 ose 5x5  
pikselë) në pjesën e sipërme ose të poshtme të faqes.

Një praktikë tjetër mashtruese është e ashtuquajtura ‘stiva e reklam-  
ave’, ku reklama të shumta shtresohen njëra mbi tjetrën në një plasim  
të vetëm të reklamave. Përmes kësaj praktike agresive, piratët fitojnë  
dobi të mëdha, madje edhe në rastin e shërbimeve “pa pagesë” që  
shkelin DPI-të.

## 7.5 Praktikrat më të mira

### Hyrje

Përhapja e rrjeteve sociale dhe informacioni me burim të hapur së  
bashku me nevojën e tyre për të reklamuar dhe për të arritur sa më  
shumë përdorues të fundit, i detyrojnë shkelësit e DPI-ve të ekspozojnë  
të dhënat e tyre në internet. Mbledhja e informacionit në lidhje  
me shkelësit e DPI-ve në hetimet virtuale nuk mund të konsiderohet  
detyrë e thjeshtë. Kryerja e hetimeve virtuale kërkon përgaditje dhe  
një masë planifikimi paraprak të sofistikuar për të siguruar që detyra  
të kryhet në mënyrë efikase dhe të fokusuar, duke qenë gjithmonë të  
vetëdijshëm për gjurmët që hetuesi lë prapa vetes.

Megjithëse nuk ekziston ndonjë listë pikash të përshtatura për të gjithë,  
për shkak të kompleksitetit dhe larmisë në secilin rast, ka disa çështje  
që hetuesi duhet të ketë parasysh në fazën e para-planifikimit të një  
hetimi në internet:

- Mbrojtja e anonimitetit të personave;
- Hulumtimi i gjerë, ruajtja e gjurmëve dhe kopjeve rezervë për të mbështetur gjetjet;

- Të dokumentohen TË GJITHA provat e zbuluara në internet me shenjat e sakta të kohës;
  - Fotografi ekrani të të gjitha provave me identifikim të qarta kohor për secilin artikull;
  - Bëhen kopje të faqeve të internetit;
- Regjistrohet çdo gjurmë (alias, email, ID e përdoruesit) që hetuesi i “ofron” faqes kundërvajtëse të internetit me shenjat e qarta kohore;
- Të ketë njohuri të mirë të mjedisit nën hetim, të familjarizohet mirë me terminologjinë që përdoret nga shkelësit e DPI-ve, opsionet që ofrojnë faqet e internetit, etj; dhe
- Në rastet tejkuftare, të kërkohet ndihma ndërkombëtare.

## Anonimiteti

Ndërsa rrjetet sociale dhe burimet e informacionit në internet ose i mundësojnë të shënjestruarve të shohin se kush i ka hulumtuar, ose ofrojnë indikacione të qarta se kush po shikon informacionin e tyre, hetuesit duhet ta ruajnë fshehtësinë e identitetit të tyre gjatë kryerjes së hulumtimeve në internet. Këto janë disa nga veprimet që mund të kryhen nga hetuesit për të kryer hetime anonime në internet:

- **Krijoni llogari** të re emaili që do të përdoret për hetimet sipas nevojës. Ndërsa anonimiteti është i rëndësishëm, hetuesit duhet të fillojnë të krijojnë një personalitet të përshtatshëm që nuk ka asnjë lidhje me identitetin e tyre. Kjo llogari emaili nuk duhet t’i referohet në asnjë mënyrë identitetit të hetuesit. Disa këshilla për arritjen e kësaj janë si më poshtë:

- Mos jepni informacion që potencialisht mund të identifikojë identitetin e vërtetë të hetuesit. Pa pseudonime të vërteta, ditëlindje, numra bexhi, indikatorë gjeografikë, ekipe sportive ose emra fëmijësh në seksionin e identifikimit të Përdoruesit;
- Mos iu përgjigjini pyetjeve të sigurisë me saktësi;
- Mos e lidhni këtë llogari të emailit me adresa të tjera legjitime të postës elektronike;

- Mbani shënime për ato që janë shkruar, si dhe mos harroni fjalëkalimin.
- **Krijoni llogari të reja në mediat sociale të** shoqëruara me llogarinë e emailit të sapokrijuar. Kur bëhet fjalë për profile të fshehta në media sociale, hetuesit duhet të dinë (a) Kush mund të shohë kë, përmes këtyre platformave; dhe (b) Çfarë mund të gjejnë duke shfletuar llogaritë në fjalë.
- **Të merret parasysh përdorimi i zgjidhjeve VPN.** Përdorimi i zgjidhjeve dhe shërbimeve VPN gjatë kryerjes së hetimit në internet i mundëson hetuesve të lidhen në rrjetin e tyre përmes tunelit VPN dhe në të njëjtën kohë të dalin nga lokacion tjetër në të gjithë botën. Për shembull, rrjeti VPN nordvpn.com ofron pika dalëse në mbi 60 vende në të gjithë planetin. Fatkeqësisht, shumica e shërbimeve dhe zgjidhjeve VPN nuk janë falas. Në të njëjtën kohë, **nuk rekomandohet** që hetuesit të përdorin zgjidhje pa pagesë për proxy/VPN. Hetuesit duhet të kenë gjithmonë në mendje se edhe nëse trafiku i tyre është enkriptuar duke kaluar në pikat e rrjetit VPN, përveç nëse ka një enkriptim end-to-end, ata i falin një masë besimi pikës dalëse që e dekripton trafikun e tyre, siç paraqitet në tekst të thjeshtë.
- **Të merret parasysh përdorimi i TOR për anonimitet.** TOR (Projekti Onion Router) është një rrjet pikash, dizenuar nga Laboratori i Kërkimeve Detare të Shteteve të Bashkuara për Marinën Amerikane. Ky rrjet i pikave përdoret për të kaluar trafikun e përdoruesve në një host destinacioni, duke përdorur kriptimin dhe rutimin nëpër shtigje rastësore. TOR punon vetëm me trafikun e Protokollit të Kontrollit të Transmetimit (TCP) dhe vetëm ho-sti i destinacionit është në gjendje të shikojë IP-adresat e pikave dalëse, ndërsa IP-adresa burimore e hostit që ka iniciuar komunikimin mbetet e pazbuluar. Deri më tani, por pasi që një listë e pikave dalëse TOR është në dispozicion publik nëse shënjestra e hetimit bllokon qasjen nga IP-adresat që vijnë për pikat TOR, hetuesit nuk do të jenë në gjendje të arrijnë objektivin e tyre. Një tjetër çështje kyçe për t'u marrë parasysh gjatë hetimit në internet përmes TOR, është se edhe pse IP-adresa burimore e hetuesve mbetet e fshehur, vargu i agjentit përdorues do të kalojë përsëri në faqen që shkel DPI-të. Pra, nëse për shembull hetuesit pretendojnë të jenë rusishtfolës,



megjithatë vargu i tyre i agjentit të përdoruesit zbulon se gjuha e tyre është 'EN-US', kjo mund të ngjallë dyshime. Për më tepër, nëse hetuesit pretendojnë të jenë të vendosur në SH.B.A., por janë rregullisht në internet herë pas here në përputhje me dikë që ndodhet në Zonë të Kohës Lindore, kjo mund të informojë edhe vetë shënjestrën e hetimit; dhe

- **Të merret parasysh përdorimi i Makinës Virtuale për të gjitha hetimet në internet.** Makinat Virtuale (ose VM-të) janë aplikacione virtualizimi mes platformash që imitojnë sjelljen e një kompjuteri tjetër (sekondar) brenda makinës së hetuesit. Përveç mundësimit që përdoruesit të ekzekutojnë disa sisteme operative të ndryshme në të njëjtin kompjuter - me fleksibilitet të madh në konfigurimin e rregullimeve dhe personalizimin e softuerit ose programeve të treta të instaluara - VM ofron edhe dobi të sigurisë, veçanërisht kur hetojnë aplikacione, skedarë dhe faqe interneti me rrezik. Pasi të futen në mjedisin VM, hetuesit gjithashtu përfitojnë nga aftësia për të krijuar pamje të nivelit të sistemit, për të rikuperuar ose rivendosur imazhe dhe shërbime VM sipas kërkesës.

## 8. INTELIGJENCA NGA BURIME TË HAPURA

### 8.1 Hyrje

Inteligjenca me Burim të Hapur (OSINT) i referohet praktikës së mbledhjes së informacionit nga burime publikisht të disponueshme që nuk kërkojnë metoda të fshehta ose klandestine të marrjes së informatave. Megjithëse OSINT është aktivitet relativisht i ri për agjencitë e zbatimit të ligjit, organizatat dhe agjencitë e mëdha (të tilla si Interpol dhe Europol) po promovojnë dhe investojnë sistematikisht në OSINT përmes punëtorive, seminareve dhe aktiviteteve të tjera, për shkak të rëndësisë së saj për hetimet penale.

Në veçanti në hetimet virtuale të shkeljeve të DPI-ve, OSINT është aktivitet qenësor dhe integral sesa thjesht një levë në procesin e hetimit. Kjo është e dukshme nga ekosistemi i shkeljeve të DPI-ve, ku thelbi i shkeljes është që shumica e palëve ose të ndërveprojnë me anë të internetit ose të përdorin shërbimet thelbësore të infrastrukturës së internetit për të ofruar përmbajtjen kundërvajtëse. Kjo e fundit paraqet një sfidë të veçantë, pasi një palë mund të mos jetë përfshirë detyrimisht në mënyrë proaktive në ndonjë veprimtarie kundërvajtëse, ngjashëm me shërbimin postar që mund të shpërndajë narkotikë të paligjshëm. Sidoqoftë, veprimi me OSINT do të duhej të kapte të gjitha informatat relevante, si dhe t'i verifikonte ato, ashtu që të mundësohet veprimi pasues teknik apo ligjor.

Parimet e Shoqatës së Shefave të Policisë së Mbretërisë së Bashkuar (ACPO) duhet të respektohen gjatë kryerjes së hetimit të bazuar në OSINT<sup>46</sup>. Megjithëse OSINT nuk përfshin detyrimisht qasjen direkte në sistemet e të dyshuarit, hetuesi do të ketë nevojë për një pasqyrë të qartë të teknologjive thelbësore të mundësimin të internetit si DNS, sistemet autonome, protokollet, standardet e kodimit të rrjedhave (stream), rrjetet e ofrimit të përmbajtjeve. Identifikimi i lokacionit të shërbimeve, domeneve dhe IP-adresave duhet theksuar veçanërisht, pasi këto mund të jenë të fshehura, të mjegulluara dhe të anonizuara - jo detyrimisht për të mos lejuar zbulimin, por për të ofruar

<sup>46</sup>[www.digital-detective.net/digital-forensics/documents/ACPO\\_Good\\_Practice\\_Guide\\_for\\_Digital\\_Evidence\\_v5.pdf](http://www.digital-detective.net/digital-forensics/documents/ACPO_Good_Practice_Guide_for_Digital_Evidence_v5.pdf)

nivelin e kërkuar të shërbimit, siç përshkruhet në rastin Cloudflare dhe shërbimet tjera të mbrojtjes së privatësisë.

Regjistrimi i detajuar i veprimeve dhe kohës (Parimi 3 i ACPO) është me rëndësi kyçe në OSINT. Me kërkimin dhe marrjen e informatave nga burimet e jashtme dhe potencialisht jo të besueshme, hetuesi duhet të vlerësojë që sistemet bazë janë komplekse dhe dinamike, e si të tilla, gjendja e tyre mund të ndryshojë në masë të madhe gjatë një hetimi. Për shembull, në qasjen “Përcille Transmetimin”, pasi përmbajtja kundërvajtëse mund të ofrohet nga Rrjeti i Ofrimit të Përmbajtjeve (CDN), ka gjasë që domeni ose IP-adresa të japë më shumë se një lokacion efektiv. Nga ana tjetër, hetimi ‘Përcilli paratë’ mund të ofrojë gjetje (përsëri IP-adresat dhe domenet) që janë më pak të paqëndrueshme, pasi që hetimi i tillë përqendrohet në portalet e faturimit, llogaritë e pagesave (si PayPal dhe kuletat bitcoin) dhe strukturat e tjera që kanë “jetëgjatësi më të madhe”. Ky lloj përjashtimi vlen edhe për shumë burime eksterne OSINT, pasi ato mund të kapin informacionin në kohë të ndryshme të kaluara, e për këtë arsye, paraqesin informacione kundërtënëse ose të mospërputhshme. Në këtë kuptim, disa vegla OSINT me bazë forenzike përpriqen të kompensojnë, duke ruajtur edhe periudhat kohore të të dhënave.

Ekosistemi i shkeljeve të DPI-ve përfaqëson si mundësi ashtu edhe sfida për hetuesin me OSINT. Suksesi i modeleve të biznesit me shkelje DPI-sh bazohet kryesisht në premisën që produktet dhe shërbimet kundërvajtëse janë lehtësisht të zbulueshme, të dukshme dhe të qasshme për përdoruesin/klientin përfundimtar. Në këtë drejtim, OSINT mund të jetë shumë efektive, si dhe nuk kërkon aftësi të posaçme për të zbuluar shtresën e informatave që i paraqitet klientit.

Prandaj, jo vetëm që faqet janë të dukshme, por pronarët kryejnë aktivitete të optimizimit të motorëve të kërkimit (SEO) për të përmirësuar renditjen e tyre.

OSINT është një praktikë e mirënjohur dhe e mirë për hetuesin që të ndërtojë një portofol me mjete të ndryshme për të kryer detyrën e caktuar, ashtu që të verifikojë e konfirmojë gjetjet e tij/saj. Në veçanti me OSINT, është me rëndësi të madhe që të përdoren më shumë se një

vegël për kryerjen e një veprimi të veçantë. Për shkak të natyrës së të dhënave OSINT, mjete të ndryshme pritet të prodhojnë informacione të ndryshme, pasi ato janë të lidhura me strategjitë lokale të caching-ut dhe ruajtjes, mënyrën në të cilën bëjnë kërkime në sisteme të gjalla, si dhe kohët e atyre kërkimeve. Është detyra e hetuesit të interpretojë dhe t'i japë përparësi informacionit të prodhuar nga veprimi me OSINT.

Rezultatet e prodhuara nga veglat OSINT e sidomos ato që janë me burim të hapur ose pa pagesë, duhet të përdoren si udhëzues, ndërsa hetuesi duhet të veprojë me kujdes kur interpreton rezultatet. Mbështetja dhe besueshmëria e softuerit falas OSINT mund të jenë të kufizuara, pasi mund të mos mirëmbahen vazhdimisht.

## 9. PROVAT DIGJITALE

### 9.1 Hyrje

Për t'u përballur me sfidat e harmonizimit të proceseve të hetimit përtej kufijve, kur kemi të bëjmë me shkeljet virtuale të DPI-ve, ky kapitull ka qëllim të ndihmojë hetuesit në të gjitha fazat e trajtimit të provave të mundshme digjitale. Sipas standardit ISO/IEC 27037, këto faza janë **identifikimi, mbledhja, marrja dhe ruajtja** e provave digjitale. Megjithëse shumë agjenci kanë udhëzuesit e tyre kombëtar, procedurat standarde të veprimit dhe protokollet, është qenësore që reaguesit në vijë të parë dhe hetuesit të çmojnë kompleksitetin që mund të kenë vendet e ngjarjes së krimit dhe brishtësinë e provave digjitale, të cilat mund të dëmtohen ose ndryshohen lehtësisht për shkak të trajtimit të parregullt, qoftë rastësisht apo me qëllim. Prandaj, vetëm personeli i trajnuar në mënyrë të mirëfillt duhet të përpiqet të sekuestrojë pajisjet bazë, duke mbajtur shënimet e rregullta të të gjitha provave digjitale, me procese të strukturuar që pranohen nga gjykatat.

Një çështje që duhet menduar nga hetuesit është që shumë raste të shkeljes së DPI-ve mund të kërkojnë praninë e njërive të tjera në reagim (p.sh. ekzaminuesit forenzikë) në vendin e ngjarjes për të kryer procedurën e triazhimit - që është prioritizimi dhe qasja me strategji të marrjes së provave dhe artefakteve digjitale të gjetura në vendin e

ngjarjes - ose kopjimi dhe reagimi në vend të ngjarjes. Për shembull, kur sekuestrohen dhe merren pajisje transponderi të drejtpërdrejta, duhet të ketë trajtim të kujdesshëm të tyre, për të nxjerrë e regjistruar informatat e paqëndrueshme (si lidhjet e hapura të rrjetit, rrjedhat e përmbajtjeve në hyrje, etj.).




Figura 3 - Lloje të ndryshme të provave digjitale

## 9.2 Vendi i ngjarjes - skena e krimit

Pas mbërritjes në skenën e krimit, hetuesi duhet të sigurojë ose të ketë qasje në këto:

- **Sigurimi i vendit të ngjarjes.** Ky mund të jetë një nga rolet kryesore të një reaguesi të parë, që të ketë kufij përreth zonës së vendit të ngjarjes, si dhe të mbahen të gjithë jashtë e larg saj, për ruajtje të mirë të provave dhe gjasa më të mëdha për rezultate të vlefshme kriminalistike. Duhet theksuar po ashtu se në asnjë rrethanë nuk duhet të lejohet që i dyshuari të prekë ndonjë pajisje elektronike që është e pranishme dhe as të ko-

munikojë me askënd. Sistemet mund të ndalen në distancë, përmes internetit ose celularit, apo edhe përmes ndërprerësve të mençur, ku mund të humben apo shkatërrohen prova të rëndësishme;

- **Materiali vizual** (p.sh. fotografitë) e vendit të ngjarjes, së bashku me sistemin e dyshuar (pamja e përparme dhe e pasme, si dhe lidhja në rrjet të të gjitha pajisjeve), ashtu që zyrtarisht të mbyllet gjendja e vendit të ngjarjes dhe pajisjeve, pas mbërritjes së reaguesve të parë. Ky material do të jetë i dobishëm edhe për ekipin e ekspertëve forenzikë, nëse ka nevojë të replikohet pajisja(et) dhe mjedisi i lidhur në rrjet në kushte laborator;
- **Dokumentacioni i detajuar** i të gjitha veprimeve të ndërmarra;
- Dokumentimi i **nivelet profesional dhe fushës së ekspertizës së të dyshuarve**; dhe
- **Ruajtja e provave**. Dështimi në ruajtjen e provave është paraardhës i dështimit në ndjekje penale.

### 9.3 Çështja e pajisjeve dhe Pakoja e veglave të hetimit

‘Pakoja e veglave të marrjes së provave digjitale’ i referohet pajisjeve dhe materialeve që duhet të merren për të trajtuar e menaxhuar një skenë krimi. Në shumicën e rasteve, pajisjet që përmbajnë prova digjitale mund të merren me anë të veglave standarde të sekuestrimit. Sidoqoftë, të gjitha skenat e krimit mund të konsiderohen unike, kështu që përdorimi i veglave duhet t’i përshtatet çdo situatë të caktuar. Shumësia dhe shumëllojshmëria e pajisjeve që mund të hasen gjatë një hetimi të shkeljes së DPI-ve kërkojnë pako fleksibile veglash, të shoqëruar edhe me një larmi procedurash. Rekomandohet gjithashtu që hetuesit të mbajnë një lloj dosjeje të burimeve të cilave u referohen, nëse situata kërkon njohuri dhe aftësi përtej kapaciteteve të tyre.

Kjo pako veglash për hetime duhet të përgatitet paraprakisht, duke

marrë parasysh ose kushtet e mundshme që paraqiten në skenën e krimit, ose veprimet që do të kërkohen nga hetuesit. Sa i përket veprimeve të ndërmarra në skenë, hetuesit duhet të marrin në konsideratë:

- Kryerjen e një skanimi të rrjetit nëse është e mundur;
- Mbulimi i trafikut të rrjetit për periudha të caktuara kohore, ku çdo gjë duhet të dokumentohet;
- Qasja në kompjuter për të kërkuar vegla administrimi që paraqesin informatat e përdoruesit dhe llogaritë e emailit;
- Kryerja e kontrolleve në skedarët e regjistrimeve;
- Identifikimi i IP-adresave të përdoruesve të tjerë;
- Kërkimi i të dhënave të klientit (qoftë në format digjital ose fizik);
- Kërkimi i informatave financiare (qoftë në format digjital ose fizik);
- Nxjerrja e detajeve të hyrjes (login) - edhe emrin e përdoruesit edhe fjalëkalimet (ose përmes përdorimit të programeve të caktuara forenzike, ose me intervistim të të dyshuarit); dhe
- Dokumentimi në detaje i të gjitha veprimeve të ndërmarra.

Për më tepër, duhet krijuar një listë specifike e pajisjeve si dhe të azhurnohet rregullisht, për t'i ndihmuar hetuesve derisa janë në terren, për mbledhjen dhe përpunimin e provave. Kjo listë duhet të përfshijë artikuj të tillë si:

- Fletore e lapsa (nëse dokumentacioni merret me dorë);
- Formularë të standardizuar për dokumentacion (nëse ka);
- Doreza;
- Kamera digjitale/regjistruar zëri (plotësisht të mbushur me rrymë);
- Pako kaçavidash, me çdo lloj koke të imagjinueshme;
- Qese letre të kaftë për dëshmi;
- Çanta të ruajtjes anti-statike ose me kafaz “faraday”;
- Etiketat e provave;
- Llamba dore;

- Shirit provash dhe shirit paketimi;
- Lapsa flomaster;
- Etiketa;
- Rrathë gome (ose kapëse plastike);
- Siguresa regjistrimi shënimesh (për hard-disk);
- Depozita adekuate të pastruara (Lloje të ndryshme të mediave sterile);
- Adapterë;
- Kabllo;
- Laptop: platforma e trajtimit forenzik; dhe
- Platforma forenzike për pajisje mobile.

## 9.4 Llojet e të dhënave

Ka lloje të ndryshme të të dhënave që duhen trajtuar gjatë kryerjes së një hetimi forenzik kompjuterik. Këto klasifikohen zakonisht nga shkalla e paqëndrueshmërisë së tyre:

- Të dhëna të paqëndrueshme - të dhëna që zhduken kur pajisja fiket. Si pasojë, sugjerohet kopjimi i menjëhershëm në vend (p.sh. nga pajisja që është në funksion, në të “gjallë”);
- Të dhëna të paqëndrueshme - të dhëna që mbeten në pajisje dhe mund të transportohen drejt vendit ku mund të kryhet kopjimi dhe analiza e duhur forenzike.

Sipas standardit ISO/IEC 27037, “Provat digjitale mund të jenë të brishta për nga natyra. Ato mund të ndryshohen, të ngacmohen apo shkatërrohen për shkak të trajtimit apo manipulimit të parregullt”. Ata që merren me provat digjitale duhet të jenë kompetentë për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet dhe pasojat e veprimeve të mundshme kur merren me prova digjitale. Dështimi në trajtimin e mirëfilltë të provave digjitale mund t’i bëjë provat e mundshme digjitale në ato pajisje krejtësisht të papërdorshme.



Për të shmangur dëmtimin dhe humbjen e të dhënave potencialisht të rëndësishme, manipulimi i sistemit mund të bëhet në pajtim me katër parimet e përgjithshme të ACPO-s:

- Nuk duhet të ndërmerren veprime që ndryshojnë të dhënat e gjetura në kompjuter apo medium të depozitimit, e të cilat më vonë mund të jenë të nevojshme për gjykatë;
- Në rrethanat kur personi konsideron të nevojshme të qaset në të dhënat origjinale të ruajtura në kompjuter apo medime depozitimi, ai person duhet të jetë kompetent për ta bërë këtë dhe të jetë në gjendje të ofrojë prova që shpjegojnë relevancën dhe implikimet e veprimeve të tyre;
- Duhet të krijohet dhe mbahet gjurma e auditimit ose ndonjë libër tjetër me të gjitha proceset e kryera për provat elektronike me bazë në kompjuter. Palët e treta të pavarura po ashtu duhet të arrijnë të vlerësojnë ato procese, si dhe të arrijnë të njëjtin rezultat; dhe
- Personi që udhëheq hetimin ka përgjegjësinë e përgjithshme të sigurojë respektimin e ligjit dhe këtyre parimeve.

## Procesi i identifikimit të provave

Faza e identifikimit është proces me tre hapa, që përfshin **kërkimin**, **njohjen** dhe **dokumentimin** e provave të mundshme që janë relevante për rastin e shkeljes virtuale. Është tejet e rëndësishme që hetuesit të prioritojnë mbledhjen e provave bazuar në paqëndrueshmërinë e tyre (shih kapitullin Llojet e të Dhënave). Sa i përket **sistemeve në funksion (live)**, renditja e duhur e marrjes së provave është ajo që ruan më së pari të dhënat më të paqëndrueshme. Mosidentifikimi i saktë i të gjitha të dhënave të paqëndrueshme përkatëse që duhen mbledhur mund të ndikojë rëndë në efektivitetin dhe rezultatin e hetimit, por edhe mund të kundërshtohet në gjykatë.

Në operacion të çfarëdo madhësie, hetuesit duhet të jenë të gatshëm të përballen dhe të marrin disa lloje të pajisjeve që mund të përmbajnë

informacione që përshkruajnë qasjen në ekosistemin e shkeljes së DPI-së. Këto pajisje janë si vijon, por pa u kufizuar në to:

- Serverë (përfshirë pajisjet e transkoderit);
- Kompjuter dhe/ose laptopë;
- Kutitë pranuese Set Top/pajisjet mobile/televizione inteligjentë;
- Tableta dhe telefona inteligjentë;
- Konzolat e lojërave;
- Ruterët;
- Disqet eksterne;
- Disqet USB; dhe
- Lexuesit e kartave dhe kartat inteligjente.

Informacioni i ruajtur në këto pajisje mund të japë detaje në lidhje me dy llojet e hetimit “Përcille Transmetimin” ose “Përcilli paratë”. Vlen të përmendet se pajisjet pritet të përmbajnë informacione qenësore në formën e llogarive email dhe korrespondencës, duke përshkruar se si individët kanë paguar për shërbime, detajet e lidhjeve me adresat IP, si dhe informata në lidhje me sasinë e të dhënave të transmetuara dhe të marra.

Një çështje thelbësore e procesit të sekuestrimit është marrja, së bashku me pajisjet e lartpërmendura, e të gjitha pajisjeve periferike (p.sh. pajisjet input ose kontrollit) karikuesit dhe furnizuesit e energjisë, kabllot dhe madje edhe doracakët që gjenden në skenën e krimit.

Një çështje tjetër për konsideratë në këtë fazë është të sigurohet që të ndërmerren veprimet e nevojshme për të mbrojtur të dhënat kalimtare ose të paqëndrueshme, që mund të humbin shpejt ose të prishen. Për këtë qëllim, duhet të sigurohen teknika me bazë softueri ose hardueri për marrjen e memorieve në to. Për më tepër, meqenëse aktiviteti në rrjet është i paqëndrueshëm dhe dinamik, duhet të bëhet hetimi

forenzik i rrjetit për aktivitetin historik dhe aktual të rrjetit, duke shënuar ngjarjet dhe aktivitetin në rrjet, ashtu siç ndodh në kohë reale. Rrjedhimisht, rekomandohet fuqimisht që hetuesit të marrin komplet rrjetin në pako, ashtu që të nxjerrin dhe ruajnë lidhjet dhe aktivitetin në rrjet të të dyshuarit, duke dokumentuar kohën e saktë të atyre ngjarjeve.

## 9.5 Grackat e bombat

Hetuesit gjithmonë duhet të kenë parasysh brenda sistemit që hetohet, mund të jenë vendosur fshehurazi softuere keqdashëse që veprojnë si grackë ose bombë logjike. Nuk është e panjohur që pajisja të ketë “minë kurth” për të shkatërruar provat e mundshme ose vetë pajisjen. Këto lloje të softuereve të sofistikuar, të instaluar paraprakisht (tërësia e komandave) janë krijuar për të shkatërruar të dhënat kritike që gjenden në pajisjet që konfiskohen, kur plotësohet një kusht i paracaktuar. Për shembull, i dyshuari mund t’i aktivizojë ata duke përdorur telekomandë ose mund të kenë “këmbëz” të vetën, kur identifikojnë ekzekutimin e një programi të caktuar, komande apo kërkimeve si ‘nmap’, ‘netstat’, ‘whois’ etj.

Më në fund, hetuesit mund të hasin ndonjë nga këto tre lloje të softuerit dashakeq të ngarkuar paraprakisht:

- ‘Hotkey Bomb’: i referohet cilitdo kombinimi tastesh që mund të ekzekutojë një Komandë apo renditje komandash;
- ‘Minë Kurth - Booby Trap’: softuer i instaluar që duket se kryen një funksion të caktuar, por në të vërtetë bën diçka krejt ndryshe; dhe
- ‘Programi i Shkëputjes dhe Qëndrimit në sistem’: softuer që qëndron brenda Memories së kompjuterit, ashtu që të mund të (ri)aktivizohet nga ndërprerja e sistemit.

Edhe pse të rrallë, këta skenarë mund të ndodhin. Si pasojë, deri sa

janë në terren, hetuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për teknologjitë e mundshme (si pajisjet infra të kuqe) që mund t'i japin të dyshuarit qasje në sistem nga largësia, apo edhe ekzistencën e programeve “mina” në pajisje, të cilat mund të dëmtojnë prova kyçe e të nevojshme për identifikimin dhe ndjekjen penale të fajtorit.

Duhet të sigurohet që askush të mos prekë tastierën (që është rregull më i shpeshtë që vlen në zbatim të urdhrave lidhur me provat digjitale), gjë që parandalon iniciimin e ndonjë renditjeje ngjarjes, të qëllimshme apo pa qëllim, të cilat mund të dëmtojnë të dhënat e brishta në pajisje.

## 9.6 Depozitimi dhe Ruajtja e Provave digjitale

Të gjitha procedurat e marrjes së provave, futjes në qese e etiketimit të tyre, duhet të zbatohen edhe për pajisjet elektronike, ashtu që të ruhet integriteti i tyre dhe të ruhen në gjendjen e tyre origjinale. Prandaj, hetuesit duhet të ndjekin protokoll të rreptë të ruajtjes së provave, të trajtojnë pajisjet digjitale me precizitet e kujdes, ashtu që t'i mbrojnë nga dëmtimet fizike dhe dëmtimet nga burimet elektromagnetike. Ekspozimi ndaj faktorëve si temperaturat ekstreme, lartësia, elektriciteti statik, lagështia ose burimet elektromagnetike, si radio frekuencat dhe magnetët, konsiderohet si burim i mundshëm i dëmtimit të provave digjitale. Sipas standardit ISO/IEC 27037, veprimtaritë bazë që hetuesit duhet të kenë parasysh janë:

- Të vendosin doreza pa fije;
- Të etiketojnë të gjitha provat dhe pajisjet e mundshme digjitale në pajtim me kriteret specifike të legjislacionit vendor lidhur me formatin e etiketimit të materialeve provuese;
- Të bllobojnë me etiketa që pengojnë prekjën pajisjet digjitale që kanë hapje dhe/ose pjesë të lëvizshme;
- Pajisjet digjitale me bateri të ngjitura duhet të kontrollohen rregullisht që të kenë furnizimin adekuat të energjisë;
- Të përdorin enë të përshtatshme për ta mbrojtur pajisjen nga

kërcënimet e mundshme. Të merret parasysh përdorimi i qeseve antistatike; qeset e letrës apo kutitë e kartonit janë gjithësi të pranueshme, por asnjëherë mos i ruani në qese plastike;

- Pajisjet digjitale të paktohen në atë mënyrë që parandalon dëmtimet nga goditjet, dridhjet, lartësitë, temperaturat ekstreme dhe radio frekuencat gjatë transportit;
- T'i kushtohet vëmendje e veçantë pajisjeve magnetike të depozitimit, që duhet të ruhen në pako magnetikisht inerte, anti-statike dhe pa grimca; dhe
- Jini vigjilent në rrethanat kur pajisjet digjitale përmbajnë prova latente, gjurmë ose biologjike, sepse mbledhja e provave të tilla duhet të bëhet para se të bëhet kopjimi i provave digjitale.

## 10. MËSIMET TË TJERA

### 10.1 Kolegji i Hetuesve të Krimit ndaj PI-së

Nëse Policia e Kosovës dëshiron të zgjerojë njohuritë e saj në hetimin e shkeljeve të DPI-ve në mjediset virtuale, rekomandohet që të vizitojë Kolegjin Ndërkombëtar të Hetimit të Krimeve ndaj PI-së (IIPCIC).

IIPCIC operohet nga Interpol-i dhe është strukturë plotësisht interaktive virtuale për trajnime për krimet PI, që ofron kurse në anglisht, spanjollisht, frëngjisht, arabisht, mandarin dhe portugalisht.

Mbi 150 vende kanë vizituar faqen e IIPCIC-së që nga fillimi dhe mbi 600 agjenci të zbatimit të ligjit janë regjistruar në trajnime. IIPCIC-ja ka për mandat të zhvillojë, koordinojë dhe administrojë programe trajnimi për të mbështetur përpjekjet ndërkombëtare për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar ndërkombëtar të PI-së.

Kursi është falas për zyrtarët e zbatimit të ligjit, por përdoruesit së pari duhet të marrin detajet e hyrjes tek

[www.iipcic.org](http://www.iipcic.org)

# SHTOJCA I - OBJEKTET E PRONËS INTELEKTUALE

## Hyrje

Prona intelektuale (PI) i referohet krijimeve mendore, si shpikjet, veprat letrare, veprat artistike, simbolet, emrat, imazhet dhe dizajnet që përdoren në tregti.

PI-ja tradicionalisht ndahet në dy kategori:

- Prona industriale, e cila përfshin shpikjet (patentat), markat tregtare, dizajnet industriale dhe treguesit gjeografikë të burimit; dhe
- E drejta e autorit që përfshin veprat letrare dhe artistike si romane, poezi dhe drama, filmat, muzikën, veprat artistike si vizatimet, pikturat, fotografitë dhe skulpturat, softueret dhe dizajni arkitektonik. Të drejtat e përafërta me të drejtat e autorit janë ato të artistëve interpretues në interpretimet e tyre, prodhuesit e fonogrameve në regjistrimet e tyre dhe transmetuesve në programet e tyre në radio dhe televizion.<sup>47</sup>

## Prona Industriale

Qëllimi i sistemit të të drejtave të pronësisë industriale është të inkurajojë dhe motivojë shpikësit dhe krijuesit, të mbrojë të drejtat e tyre dhe të rrisë besimin në mirëmbajtjen e aktiviteteve të biznesit. Të drejtat e pronësisë industriale përfshijnë:

- Patentat;
- Markat tregtare;
- Dizajnet industriale;
- Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, dhe
- Topografitë e qarqeve të integruara.

---

<sup>47</sup>Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale [www.wipo.int/about-ip/en/](http://www.wipo.int/about-ip/en/)

Bartësit e të drejtave duhet të regjistrojnë pronën e tyre industriale në API për të gëzuar mbrojtje në Kosovë. Bartësit e të drejtave, përfshirë subjektet e huaja, të cilët nuk regjistrojnë pronën e tyre industriale në API mund të kenë akoma të drejta të caktuara, por statusi i tyre duhet të sqarohet gjithmonë me API-në përpara se të fillojë hetimin.

## **Patentat**

Patenta është e drejtë ligjore ekskluzive që jepet për shpikje. Shpikja është produkt ose proces që siguron një mënyrë të re për të bërë diçka, ose ofron zgjidhje të re teknike për një problem.

## **Markat tregtare**

Marka tregtare është shenjë dalluese që dallon mallra ose shërbime të caktuara si ato të ofruara nga një person ose ndërmarrje specifike nga të njëjtat mallra ose shërbime të ndërmarrjeve të tjera. Origjina e saj daton që nga kohërat antike, kur mjeshtrit riprodhonin nënshkrimet e tyre, ose “markat” në produktet e tyre artistike ose të përdorimit. Me kalimin e viteve, këto shenja evoluan në sistemin e sotëm të regjistrimit dhe mbrojtjes. Sistemi ndihmon konsumatorët të identifikojnë dhe blejnë një produkt ose shërbim sepse natyra dhe cilësia e tij, e treguar nga marka e tij unike tregtare, plotëson nevojat e tyre.

## **Dizajnet industriale**

Dizajni industrial është aspekti ornamental ose estetik i një artikulli. Dizajni mund të përbëhet nga tipare tre-dimensionale, si forma ose sipërfaqja e një artikulli, ose nga tiparet dy-dimensionale, të tilla si modelet, linjat ose ngjyrat. Dizajnet industriale aplikohen në një larmi të gjerë të produkteve të industrisë dhe artizanateve: nga instrumentet teknike dhe mjekësore te orët, stolitë dhe sendet tjera luksoze; nga mjetet e ngrënies e pajisjet elektrike te automjetet dhe strukturat arkitektonike; nga dizanjet e tekstilit te produktet e kohës së lirë. Dizajni industrial duhet të tërheqë syrin. Kjo do të thotë që një dizajn industrial është më së pari i një natyre estetike dhe nuk mbron tipare teknike të artikullit në të cilin aplikohet.

## Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës

Treguesi Gjeografik (GI) është emër i një rajoni, një vendi specifik ose në raste të veçanta emri i një shteti, i cili përdoret për të përshkruar një produkt me origjinë nga ai rajon, vend ose shtet specifik, posedon një cilësi, reputacion ose ndonjë karakteristikë tjetër specifike të cilat vijnë si rezultat i origjinës gjeografike, prodhimit dhe/ose përpunimit dhe/ose përgatitjes që zhvillohen tërësisht në emrin e zonës së përcaktuar gjeografike, që përdoret për të treguar që produkti ka origjinën në një vend ose një rajon ose një vend specifik, cilësia, reputacioni ose karakteristikat e tjera të të cilit thelbësisht i atribuohen origjinës së saj gjeografike; si dhe të paktën një nga hapat e prodhimit të së cilit zhvillohet në zonën e përcaktuar gjeografike.

Emërtimi i origjinës (DO) është emri i një rajoni, një vendi specifik ose në raste të veçanta, emri i një shteti, i cili përdoret për të përshkruar një produkt me origjinë nga ai rajon, vend ose shtet specifik, cilësitë ose karakteristikat e të cilit janë thelbësisht ose ekskluzivisht si pasojë e një mjedisi të veçantë gjeografik me faktorë natyrorë dhe njerëzorë të trashëguar nga ky mjedis, si dhe si pasojë e prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes së produktit i cili është zhvilluar tërësisht në zonën e përcaktuar gjeografike.

## Topografisë e qarqeve të integruara

Topografia e një qarku të integruar është renditja tri-dimensionale e elementeve, të paktën njëri prej të cilëve është element aktiv, dhe i disa ose të gjitha ndërlidhjeve të qarkut të integruar, ose renditja e tillë tre-dimensionale e përgatitur për një qark të integruar që destinohet për prodhim.

Qarku i integruar nënkupton një produkt, në formën e tij përfundimtare ose formë të ndërmjetme, në të cilin elementët, të paktën njëri prej të cilëve është element aktiv, si dhe disa ose të gjitha ndërlidhjet janë formuar në mënyrë integrale në dhe/ose në një pjesë të materialit dhe që ka për qëllim të kryejë një funksion elektronik.



Topografia mbrohet nëse është origjinale, d.m.th. nëse është rezultat i përpjekjes intelektuale të vetë krijuesve të saj dhe nuk është e zakonshme midis krijuesve të projekteve të shtrirjes dhe prodhuesve të qarqeve të integruara në kohën e krijimit të saj.

## **E drejta e autorit**

### **Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuara me të drejtat e autorit**

E drejta e autorit, ashtu siç ekziston në sistemin evropian kontinental të cilit Kosova i përmbahet, quhet “e drejta e autorit” dhe merret me mbrojtjen ligjore të autorëve në veprat e tyre. Si rregull, autorët mbrohen për vepra në fushat letrare, artistike, muzikore, shkencore dhe të ngjashme, si për romanet, poezitë, kompozimet muzikore, skulpturat, pikturat, vizatimet, veprat kinematografike, arkitekturën, koreografinë, fotografimin dhe të ngjashme; veprat e tilla duhet të jenë krijime intelektuale dhe të përmbushin një nivel të caktuar të kreativitetit. Për vepra të tilla, autorët mbrohen rregullisht me të drejta jo-ekonomike dhe ekonomike. Të drejtat jo-ekonomike mbrojnë interesat personale dhe artistike të autorit në veprën e tij dhe quhen të drejta morale; ato përfshijnë në veçanti të drejtën e atësisë (e drejta për t’u emëruar si autor i veprës, për të qëndruar anonim, ose për të zgjedhur pseudonim), e drejta e shpërndarjes (akti i parë i vënies së veprës në dispozicion të publikut në çfarëdo forme), e drejta e integritetit të veprës (në veçanti e drejta për të kundërshtuar çdo gjymtim apo modifikim tjetër të padëshiruar), si dhe e drejta e tërheqjes (e drejta për të revokuar caktimin e të drejtave të tij pronësore nëse ka arsye serioze morale për këtë, me kusht që i ceduari të kompensohet për dëmin e shkaktuar nga revokimi i tillë). Për më tepër, të drejtat ekonomike njohin rregullisht kontrollin ekskluziv të autorit mbi shfrytëzimin e veprave të tij, ashtu që të mund të ndalojnë ose autorizojnë një gamë të gjerë përdorimesh. Në disa raste, ligji njih vetëm të drejtën ligjore të kompensimit në vend të të drejtës ekskluzive. Të drejtat ekskluzive u nënshtrohen kufizimeve dhe përjashtimeve të rregulluara shprehimisht në favor të publikut të gjerë. Kohëzgjatja e mbrojtjes zakonisht është e kufizuar në 70 vjet pas vdekjes së autorit. E drejta e shpërn-

darjes dhe e drejta e tërheqjes sipas Ligjit për të Drejtat e Autorit të Kosovës zgjasin për tërë jetën e autorit. Mbrojtja e tillë mëton të theksojë rëndësinë e krijimit për kulturën duke i mundësuar autorit të përfitojë nga shfrytëzimi i veprave të tij.

Meqenëse të drejtat e autorit nuk mbrojnë ndonjë arritje jo-kreative, por arritje të tilla të tjera janë njohur ndërkombëtarisht të kenë vlerë të madhe për disponueshmërinë e kulturës në një shoqëri, vendet e sistemit të Evropës Kontinentale kanë futur edhe të ashtuquajturat të drejta të përafërta me të drejtën e autorit. Tipari i tyre kryesor është se ato nuk mbrojnë “veprat” në kuptimin e të drejtave të autorit, por arritje të ngjashme të cilat pjesërisht promovojnë ose ndihmojnë në vënien e veprave në dispozicion të publikut. Të drejtat kryesore të përafërta të njohura në të gjithë botën janë të drejtat e artistëve interpretues (këngëtarë, muzikantë të tjerë, valltarë, aktorë dhe të tjerë që interpretojnë vepra); prodhuesit e fonogrameve; prodhuesit e filmave; dhe organizatat e transmetimit. Lloje të tjera të të drejtave të përafërta janë vendosur në vendet e tjera. Gjithashtu, kohëzgjatja e mbrojtjes është më e shkurtër se ajo e të drejtave të autorit. Ndërsa interpretuesit mbrohen për arritjet e tyre artistike, p.sh., shfaqja e veprave, bartësit e tjerë të të drejtave të përafërta janë të mbrojtur për investimet e tyre teknike, organizative dhe financiare në prodhimin e regjistrimeve, në aktivitetin e transmetimit, etj.

Mbrojtja e së drejtës së autorit jepet pa ndonjë formalitet. Kështu, nuk kërkohet regjistrim i të drejtave nga Ligji në Kosovë. E drejta lind posa të krijohet vepra.

## **SHTOJCA II - PIKAT E KONTAKTIT**

### **Kosova - Informatat e Kontaktit**

#### **Agjencia për Pronësi Industriale**

**Adresa:** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Rr. “Muharrem Feiza”, p.n. Lagja e Spitalit, 10000 Prishtinë  
**Tel:** +381 (0) 38 200 36 544  
**Fax:** N/A  
**Faqja:** [www.kipa-ks.org](http://www.kipa-ks.org)  
**Email:** [nezir.gashi@rks-gov.net](mailto:nezir.gashi@rks-gov.net)

#### **Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përfaqëta**

**Adresa:** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Sheshi Nëna Terezë pa nr. Prishtinë  
**Tel:** +381 (0) 38 200 563  
**Fax:** N/A  
**Faqja:** <http://www.autori-ks.com/>  
**Email:** [nezir.gashi@rks-gov.net](mailto:nezir.gashi@rks-gov.net)

#### **Policia e Kosovës, Njësia për Krime Ekonomike**

**Adresa:** Rr. “Luan Haradinaj” 10000, Prishtinë- Kosovë  
**Tel:**  
**Fax:**  
**Faqja:** [www.kosovopolice.com](http://www.kosovopolice.com)  
**Email:**

#### **Policia e Kosovës, Njësia për Krime kibernetike**

**Adresa:** Rr. “Luan Haradinaj” 10000, Prishtinë- Kosovë  
**Tel:**  
**Fax:**  
**Faqja:** [www.kosovopolice.com](http://www.kosovopolice.com)  
**Email:**

**Policia e Kosovës, Njësia e Bashkëpunimit Ligjor Ndërkombëtar (ILECU)**

**Adresa:** Rr. "Luan Haradinaj" 10000, Prishtinë- Kosovë

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja:** [www.kosovopolice.com](http://www.kosovopolice.com)

**Email:** \_

**Dogana e Kosovës**

**Adresa:** Veterniku 1, Zona Industriale - Prishtinë

**Tel:** +381 (38) 540 350

**Fax:** +381(38)542065

**Faqja:** [www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)

**Email:** [info@dogana-ks.org](mailto:info@dogana-ks.org)

**Info:** <http://dogana.rks-gov.net/en/Kontakt>

**Inspektorati i Tregut**

**Adresa:** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Rr. "Muharrem Feiza", p.n. Lagja e Spitalit, 10000 Prishtinë

**Tel:** +381 (38) 512407,

**Fax:** <tel:038512798>

**Faqja:** [www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)

**Email:**

**Prokuroria e Shtetit**

**Adresa:**

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja e internetit:**

**Email:**

## **Këshilli Prokurorial**

**Adresa:**

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja e internetit:**

**Email:**

## **Këshilli Gjyqësor**

**Adresa:**

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja e internetit:**

**Email:**

## **Agjencia e Barnave dhe Produkteve Mjekësore**

**Adresa:**

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja e internetit:**

**Email:**

## **Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit**

**Adresa:**

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja e internetit:**

**Email:**

## **Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit**

**Adresa:**

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja e internetit:**

**Email:**

## **Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara**

**Adresa:**

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja e internetit:**

**Email:**

## **Komisioni i Pavarur për Media**

**Adresa:**

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja e internetit:**

**Email:**

## **Autoriteti Rregullator për Komunikimet Postare dhe Elektronike**

**Adresa:**

**Tel:**

**Fax:**

**Faqja e internetit:**

**Email:**

## **Ndërkombëtare - Informatat e Kontaktit**

### **Observatori EUIPO**

**Adresa:** Avenida de Europa, 4, E-03008 Alicante, Spanjë

**Tel:** +34 96 513 9100

**Email:** [observatory@euipo.europa.eu](mailto:observatory@euipo.europa.eu)

**Faqja:** <https://euipo.europa.eu/ohimportal/en/web/observatory/home>

## **Interpol (Trafikimi i Mallrave të Paligjshme dhe Falsifikimi)**

**Adresa:** Sekretariati i Përgjithshëm 200, quai Charles de Gaulle  
69006 Lyon France

**Tel:** +33 (0)4 72 44 71 63

**Email:** [info@iipcic.org](mailto:info@iipcic.org)

**Faqja:** <http://www.iipcic.org>

## **Europol (Krimi PI)**

**Adresa:** Eisenhowerlaan 73, 2517 KK Hagë, Hollandë

**Tel:** +31 7 03 531575

**Email:** [o3@europol.europa.eu](mailto:o3@europol.europa.eu)

**Faqja:** <http://www.europol.europa.eu>

## **Organizata Botërore e Doganave (Grupi i Falsifikimit dhe Piraterisë)**

**Adresa:** Rue du Marché, 30, B-1210 Bruksel, Belgjikë.

**Tel:** +32 2 209 92 11

**Faqja:** <http://www.wcoomd.org/>

**Email:**

## **Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO)**

**Adresa:** 34, chemin des Colombettes, CH-1211 Gjenevë 20, Zvicër

**Tel:** +41 22 338 9111

**Faqja:** [www.wipo.int](http://www.wipo.int)

**Email:**

## **SHTOJCA III - LEGJISLACIONI**

### **Kodi Penal**

#### **Neni 289 - Cënimi i të drejtave të patentës**

1. Kushdo që, gjatë kryerjes së një aktiviteti ekonomik, përdor pa autorizim, një patentë të regjistruar ose të mbrojtur me ligj ose një topografi të regjistruar të një qarku të një gjysmëpërçuesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Sendet nga paragrafi 1. i këtij neni të prodhuara për përdorim të paautorizuar konfiskohen.

#### **Neni 290 – Cënimi i të drejtave të autorit**

1. Kushdo që nën emrin e tij apo të dikujt tjetër, shfaq apo në ndonjë mënyrë tjetër i kumton publikut punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, në tërësi apo pjesërisht, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që gjatë përdorimit të punës së mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjes së tjetrit, qëllimisht nuk cek emrin, pseudonimin ose shenjën e autorit apo të performuesit kur kjo kërkohet me ligj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.

3. Kushdo që e ndryshon, shtrembëron ose në ndonjë mënyrë tjetër e dëmton punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose paraqitjen e tjetrit, dhe e shfaq në atë formë ose në ndonjë mënyrë tjetër ia kumton në formë të tillë publikut, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

4. Kushdo që paraqet ose në ndonjë formë tjetër ia kumton publikut në mënyrë të papërshtatshme punën e mbrojtur me të drejtën e autorit ose paraqitjen e tjetrit, që është paragjykuese për nderin dhe autoritetin e autorit ose performuesit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.



5. Kushdo që pa autorizim përdor punën e mbrojtur me të drejtat e autorit ose temën e çështjes së ndërlidhur me këto të drejta, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

6. Nëse gjatë kryerjes së veprës penale nga paragrafi 5. i këtij neni, kryesi ka përfituar për vete ose për personin tjetër së paku dhjetë mijë (10.000) Euro por më pak se pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

7. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 5. i këtij neni përfiton për vete ose për personin tjetër më shumë se pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tetë (8) vjet.

8. Sendet dhe pajisjet për prodhimin e tyre nga ky nen konfiskohen.

## **Neni 291 - Shmangia e masave teknologjike**

1. Kushdo që kryen vepër të shmangies së ndonjë prej masave efektive mbrojtëse të teknologjisë ose të heqjes apo ndryshimit të të drejtave elektronike për menaxhimin e të dhënave, siç parashihet në dispozitat e ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Sendet dhe pajisjet për prodhimin e tyre nga paragrafi 1. i këtij neni konfiskohen.

## **Neni 292 - Mashtrimi i Konsumatorëve**

1. Kushdo që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike dhe me qëllim të mashtrimit të blerësve apo konsumatorëve, përdor ose posedon me qëllim të përdorimit si emër apo shenjë të tij ose shenjë të veçantë të mallrave të tij, emrin apo shenjën e tjetrit, shenjën e mallrave apo shenjën e shërbimeve të tjetrit, ose shenjën e tjetrit që lidhet me prejardhjen gjeografike ose ndonjë shenjë tjetër të veçantë të mallrave apo përbërësve të tyre, dënohet me burgim deri në (3) tre vjet.

2. Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve apo konsumatorëve, përdorë gjatë prodhimit shenjën apo modelin e tjetrit pa autorizim, ose vë në qarkullim artikujt e prodhuar në këtë mënyrë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Sendet dhe pajisjet për prodhimin e tyre nga ky nen konfiskohen.

## SHTOJCA IV - PËRKUFIZIMET<sup>48</sup>

**Shkeljet në internet:** Shkeljet që ndodhin në pjesën hapur të internetit<sup>49</sup> dhe fokusi kryesor është në shkeljet në nivel komercial, që do të thotë se veprimet kundërvajtëse “kryhen për dobi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ekonomike apo komerciale”.<sup>50</sup> Përdorimi i termave mjedis virtual dhe “online” në këtë Udhëzues përfshin çdo aktivitet në internetin e hapur, duke përfshirë faqet e internetit, faqet e nivelit më të ulët, profilet e përdoruesve në faqet e rrjeteve sociale, platformat virtuale të ankandit dhe tregtimit, emaili dhe aplikacione të lidhura në internet në pajisjet mobile.

**Ndërmjetësit:** Ndërmjetësit në internet janë subjekte - zakonisht kompani - që bëjnë bashkë ose lehtësojnë transaksionet ndërmjet palëve të treta në internet. Ata ofrojnë qasje, hosting, dërgimin ose indeksimin e përmbajtjes, produkteve dhe shërbimeve që rrjedhin nga palë të treta në internet, ose ofrojnë shërbime me bazë në internet për palët e treta të tilla.<sup>51</sup>

**Emri i domenit:** Sistemi i emrit të domeneve (DNS) shërben funksionin thelbësor dhe qëndror të mundësimin që përdoruesit e internetit të lundrojnë në internet<sup>52</sup>. Emri i domenit është adresa, e lehtësuar për përdoruesin, adresa numerike IP e një kompjuteri specifik (shih përkufizimin më poshtë). Emri i domenit ‘euipo.europa.eu’, si shembull, është i lidhur në kompjuter me adresën numerike IP

<sup>48</sup>Studimi mbi Masat Legjislative në lidhje me Shkeljet në internet të DPI-ve, EUIPO, 2018.

<sup>49</sup>Prandaj, Udhëzuesi nuk përfshin aktivitetet në pjesët e pa-indeksuara të internetit, shpesh të referuara si rrjeti i errët. Shihni përkufizimin e ‘darknet’ në f. 14 tek ‘Hulumtimi për modelet virtuale të biznesit që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale’. Faza 1. ‘Vendosja e një pasqyre të modeleve të biznesit në internet që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale’, EUIPO, korrik 2016.

<sup>50</sup>Siç përcaktohet në Recitalin 14 të Direktivës 2004/48 për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Kështu, studimi nuk përqendrohet në shkeljet e të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta që kryhen nga persona privatë si të tillë.

<sup>51</sup><https://www.oecd.org/internet/ieconomy/44949023.pdf>

<sup>52</sup>Është Korporata për Emrat dhe Numrat e Caktuar (ICANN) në internet që koordinon funksionet kryesore teknike të DNS-ve, si dhe përcakton politikat për mënyrën se si duhet të funksionojnë ‘emrat dhe numrat’ e internetit.

109.232.208.177, që do të thotë se në vend që të mbahet mend dhe të shkruhet '109.232.208.177' në shfletuesin e internetit, përdoruesi i internetit mund të shkruajë 'euipo.europa.eu' për t'u lidhur me faqen e internetit të EUIPO-s.

Teknikisht, DNS funksionon përmes një rrjeti të bazave të të dhënave të shpërndara, që operohen nga regjistrat e caktuar të emrave të domeneve. Këto databaza përmbajnë listat e emrave të domeneve dhe adresat e tyre përkatëse IP-numerike dhe kryejnë funksionin e delegimit të emrave të domeneve në adresat e tyre numerike IP, për të orientuar kërkesat për të lidhur kompjuterët në internet.

Emrat e domenit duhet të regjistrohen në regjistrin<sup>53</sup> që është përgjegjës për domenin specifik të nivelit të lartë dhe regjistrimet duhet të bëhen përmes një regjistruesi të akredituar të domeneve. Për të dhënë një shembull, nëse një kompani dëshiron të regjistrojë një emër domeni .eu, kompania duhet të kontaktojë një regjistruer të akredituar .eu, si dhe të kërkojë nga regjistruesi të parashtrojë kërkesë për regjistrimin e emrit të domenit në emër të kompanisë. Nëse emri i domenit është i lirë, si dhe të gjitha formalitetet e tjera plotësohen, emri i domenit regjistrohet dhe futet në databazën e DNS-ve .eu.

Të gjithë emrat e domeneve lidhen me një ose më shumë serverë të emrave të domeneve, që është 'server kompjuterik që përmban një bazë të dhënash të IP-adresave publike dhe emrave të tyre përcjellës të hostit, dhe në shumicën e rasteve, shërben për të zgjidhur, ose përkthyer, ata emra të zakonshëm në IP-adresa sipas kërkesës'.<sup>54</sup> Serverat DNS operohen nga subjekte që janë të autorizuar nga regjistrat ta bëjnë këtë - shpesh quhen 'menaxherë të serverit të emrave' (menaxherët e DNS). Shumë nga regjistruesit e akredituar janë gjithashtu të autorizuar të veprojnë si menaxherë DNS.

Regjistrat nuk shqyrtojnë kërkesat për emër të ri domeni kundrejt të drejtave paraprake të palëve të treta siç janë markat tregtare, emrat e ndërmarrjeve ose emrat personalë. Bartësit e tretë të të drejtave de-tyrohen kështu të zbatojnë të drejtat e tyre pasi të jetë regjistruar emri

<sup>53</sup>Shumë TLD aplikojnë një model të regjistrimit të përbashkët, në këtë rast, regjistruesit kanë mundësi të regjistrojnë emrat e domeneve direkt në bazën e të dhënave të regjistrimit. Databaza e regjistrimit administrohet më pas nga një administrator i dedikuar i regjistrimit.

<sup>54</sup>Siç përcaktohet nga LIFEWIRE, <https://www.lifewire.com/what-is-a-dns-server-2625854>

i domenit, nëse zbulojnë se emri i regjistruar i domenit shkel të drejtat e tyre.<sup>55</sup>

**Adresa IP:** termi është një shkurtime i adresës së protokollit të internetit, që është identifikues që i caktohet secilit kompjuter ose pajisje tjetër (p.sh. pajisje mobile) që lidhet në internet ose në ndonjë rrjet tjetër duke përdorur protokollin TCP/IP. Adresa IP përdoret për të lokalizuar dhe identifikuar pajisjen në komunikimet me pajisjet e tjera në rrjet.

IP-adresa mund të jetë statike, që do të thotë se adresa do të jetë e njëjtë sa herë që përdoruesi përdor llogarinë e tij me ofruesin e shërbimit për t'u lidhur në internet. IP-adresa dinamike do të thotë që ofruesi i qasjes ia cakton një nga adresat IP që ka në dispozicion në 'grumbullin e adresave' te përdoruesi kur ai ose ajo identifikohet, por IP-adresa në fjalë caktohet vetëm për një kohë të kufizuar, përkatësisht për seancën në fjalë. IP-Adresa më pas mund t'i caktohet një përdoruesi të ri.<sup>56</sup> Është e përcaktuar në marrëveshjen midis përdoruesit dhe ofruesit të qasjes se cili lloj i adresës PI aplikohet për pajisjet që mbulohen nga marrëveshja e shërbimit. Sidoqoftë, pajisjet mobile siç janë laptopët, tabletët dhe celularët mund të jenë dhe janë shumë shpesh të lidhur në internet përmes një ofruesi të qasjes, shërbimet e të cilit janë të disponueshëm në vendin ku ndodhet aktualisht përdoruesi. Shërbime të tilla zakonisht përdorin adresa dinamike IP.

**Provat digjitale:** Emrat e domeneve dhe IP-adresat janë vetëm dy lloje të provave digjitale. Siç ilustron figura më poshtë, ka shumë lloje të tjera të provave digjitale që mund të jenë të rëndësishme për t'u mbledhur në raste të veçanta që përfshijnë shkelje virtuale të DPI-ve.

---

<sup>55</sup>Definicioni nga i lartpërmenduri 'Hulumtimi për modelet e biznesit virtual që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale', EUIPO, 2016.

<sup>56</sup>Informata shtesë për adresat IP mund të gjenden, ndër të tjera, në artikullin "Çfarë është IP-adresa statike?" <https://www.lifewire.com/what-is-a-a-static-ip-address-2626012>. Termi 'grumbull adresash' buron nga këtu.




Figura 4 - Lloje të ndryshme të provave digjitale<sup>57</sup>

<sup>57</sup>Studimi mbi Masat Legjislative në lidhje me Shkeljet në internet të DPI-ve, EUIPO, 2018.



# IPRproject

Intellectual Property Rights Project

Rr. "Johan V. Hahn",  
10000 Prishtina, Kosovë  
Tel: 038 726 688

 IPRKosovo

